

PLANI KOMBËTAR I KONTIGJENCËS
PËR FLUKSET E PËRZIERA MIGRATORE,
PËR VITET 2026-2028

PËRMBAJTJA

1.	Hyrje	4
2.	Shkurtimet	6
3.	Terminologjia	8
4.	Qëllimi	11
5.	Objektivat	12
6.	Parimet themelore	14
7.	Planifikimi dhe përgatitja	16
7.1.	Kuadri ligjor	16
7.2.	Analiza e situatës në Bashkimin Evropian dhe rajon	18
7.3.	Analiza e situatës në Shqipëri, menaxhimi i kufirit	20
7.3.1.	Të huaj të parregullt të ndaluar	20
7.3.2.	Zonat kryesore të presionit migrator	21
7.3.3.	Profilizimi i migrantëve të ndaluar sipas shtetësisë	22
7.3.4.	Refuzimet në hyrje	22
7.4.	Mbrojtja Ndërkombëtare, Azili	24
7.4.1.	Lloji i mbrojtjes 2022-2024	24
7.4.2.	Sistemi i pritjes	26
7.4.3.	Kapacitetet	29
7.5.	Treguesit paralajmërues të hershëm dhe pragjet përkatëse	34
8.	Qeverisja – reagimi, koordinimi dhe menaxhimi i emergjencave në flukse të papritura	
	migratore	36
8.1.	Kuadri Institucional dhe funksionet kryesore	36

8.2.	Mekanizmi i koordinimit dhe komunikimit	38
8.3.	Mekanizmi i koordinimit dhe komunikimit në skenarin Portokalli dhe të Kuq	41
8.4.	Monitorimi i treguesve të hershëm, pragjet dhe aktivizimi i skenarëve	42
9.	Plani i përgjigjes	44
10.	Plani operacional	49
11.	Reagimi Ndërinstitucional dhe Masat e Menaxhimit për Flukset Migratore	62
12.	Buxhetimi	63

Aneksi I. Lista e kontakteve

Aneksi II: Pikat e hyrjes dhe daljes në kufijtë e Republikës së Shqipërisë

Aneksi III. Plani për krijimin e qendrave të akomodimit emergjent në qarqet Korçë, Vlorë, Gjirokastrë

Aneks IV. Plani veprimit

Aneks V. Kostimi

PLANI KOMBËTAR I KONTIGJENCËS
PËR FLUKSET E PËRZIERA MIGRATORE,
PËR VITET 2026-2028

SEKSIONI 1. Hyrje

Plani Kombëtar i Kontigjencës është hartuar në zbatim të **Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024–2030** dhe **Planin e saj të Veprimit 2024–2026**, miratuar me Vendimin nr. 271 të Këshillit të Ministrave, datë 2 maj 2024, gjithashtu ky plan bazohet në Vendimin nr. 736, datë 13 dhjetor 2023, që miraton Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës.

Ky Plan është në përputhje të plotë me parimet dhe objektivat e **Paktit Global për Migracionin**, të cilat synojnë promovimin e migracionit të sigurt, të rregullt dhe të ligjshëm. Duke përfshirë dhe përpjekjet për të ofruar mundësi për një migracion të parashikueshëm, të mbrojtur dhe të sigurt, nëpërmjet përmirësimit të aksesit të migrantëve në shërbimet thelbësore.

Gjithashtu, Plani mbështet objektivat e **Paktit Global për Refugjatët**, duke ofruar një qasje gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e refugjatëve, me fokus në sigurinë dhe dinjitetin e tyre, si dhe duke i kushtuar rëndësi nevojës për të garantuar akses në strehim, kujdes shëndetësor dhe arsim për të gjithë ata individë që janë të detyruar të largohen nga vendet e tyre të origjinës për shkak të krizave të ndryshme.

Plani është hartuar mbi bazën e metodologjive të planifikimit të emergjencave të Agjencisë së Bashkimit Evropian për Azilin (**EUAA**) dhe Agjencisë Evropiane për Rojën Kufitare dhe Bregdetare (**FRONTEX**), me qëllim krijimin e mekanizmave të përshtatshme për menaxhuar në mënyrë efektive flukset e përziera migratore, sipas standardeve të vendosura nga Bashkimi Evropian.

Qëllimi kryesor i këtij Plani Kontigjence është të garantojë një përgjigje të koordinuar, gjithëpërfshirëse dhe efektive ndaj situatave të mundshme të **flukseve të përziera migratore**, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe angazhimet kombëtare të shtetit Shqiptar.

Ky Plan është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr. 95, datë 12.06.2024, i cili përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

- Ministria e Punëve të Brendshme

- Ministria e Mbrojtjes
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Financave
- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
- Forcat e Armatosura

Në hartimin e Planit të Kontigjencës kanë kontribuar:

- Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA)
- Agjencia Evropiane për Rojën Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX)
- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)
- Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR)

SEKSIONI 2. Shkurtime

Tabela e Shkurtimeve

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
PSH	Policia e Shtetit
DKM	Departamenti i Kufirit dhe Migracionit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
QPA	Qendra e Pritjes për Azil
TFNI	Task-Forca Ndër-Institucionale
FA	Forcat e Armatosura
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror

EUAA	Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
FRONTEX	Agjencia Evropiane për Rojën Kufitare dhe Bregdetare
UNICEF	Fondi i Emergjencës për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara (UNICEF)
ASHMDF	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
QKMKM	Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Krizës Migratore
AKMC	Agjencia Kombëtare për Mbrojtje Civile
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
TFV	Task-Forca Operacionale Vendore
PKK	Plan Kombëtar i Kontigjencës
PKK	Pikat e Kalimit Kufitar

SEKSIONI 3. Terminologjia

Në kuptimin e këtij plani:

“Kontroll kufitar” është veprimtaria që kryhet në përputhje dhe për qëllim të këtij ligji, në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë, si përgjigje posaçërisht ndaj një synimi për të kaluar, ose aktit të kalimit të kufirit, që nënkupton procesin e verifikimit kufitar të identitetit të personave, mjeteve e mallrave, pavarësisht rrethanave, dhe që përbëhet nga verifikimi kufitar dhe mbikëqyrja kufitare.

“Mbikëqyrja e kufirit” është tërësia e masave që zbaton policia kufitare dhe migracionit dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, në segmentet e kufirit shtetëror ndërmjet pikave të kalimit kufitar dhe në pikën e kalimit kufitar, me qëllim parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar, kalimit të paligjshëm të kufirit dhe migracionit të parregullt.

“Kufiri shtetëror” është vija, e cila ndan territorin tokësor, ujërat e brendshme e territoriale dhe nëntokën e Republikës së Shqipërisë me shtetet fqinje, si edhe kufiri në territorin e pikave të kalimit kufitar, në aeroporte, aerodrome, porte detare, lumore,

liqenore, nëpërmjet të cilave kryhet transporti ndërkombëtar.

“Menaxhimi i integruar i kufirit” nënkupton koordinimin dhe bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar nga autoritetet dhe agjencitë përkatëse të përfshira në menaxhimin e kufirit në përputhje me kuadrin ligjor, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi, si dhe të traktateve, dypalëshe ose shumëpalëshe, të lidhura me vendet e tjera.

“Fëmijë i pashoqëruar” është shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi nën 18 vjeç, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë i pashoqëruar nga një person madhor, përgjegjës për të, sipas ligjit ose sipas traditës, ose është lënë i pashoqëruar pasi ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për sa kohë ai nuk është efektivisht nën kujdesin e një personi të tillë.

“Person pa shtetësi” është personi, i cili nuk ka shtetësinë e asnjë shteti.

“Persona që i përkasin kategorisë së veçantë” janë fëmijët, fëmijët e pashoqëruar, personat me aftësi të kufizuara, personat e moshuar, gratë shtatzëna, prind i vetëm me fëmijë të mitur, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, viktimat e gjymtimit gjenital, LGBTI, personat me sëmundje të rënda, personat me çrregullime të shëndetit mendor ose personat, të cilët kanë qenë subjekt i torturës, përdhunimit apo ndonjë forme tjetër të dhunës psikologjike, fizike apo seksuale.

“Qëndrim i parregullt” është prania në territorin e Republikës së Shqipërisë të një të huaji, i cili nuk plotëson kushtet për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

“Azil” është forma e mbrojtjes ndërkombëtare që Republika e Shqipërisë u jep refugjatëve dhe personave në mbrojtje plotësuese.

“Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët” është struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët.

“Fluksi masiv” është hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë e një mase të madhe të personave të shpërngulur, të cilët vijnë nga një shtet apo zonë gjeografike e caktuar, qoftë edhe nëse ardhja e tyre ka qenë spontane apo e ndihmuar nga një program evakuimi.

“Kërkues” është çdo shtetas i huaj ose person pa shtetësi, që ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, për të cilën nuk është marrë ende një vendim përfundimtar i formës së prerë.

“Kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare” është kërkesa për mbrojtje e paraqitur nga shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi, që kërkon ose kuptohet se kërkon të përfitojë statusin e refugjatit ose të mbrojtjes plotësuese dhe nuk kërkon shprehimisht një lloj tjetër mbrojtjeje jashtë fushës së zbatimit të ligjit për azilin në Republikën e Shqipërisë, për të cilën aplikohet veçmas.

“Moskthim” është detyrimi i ndalimit për të dëbuar apo kthyer shtetasin e huaj ose personin pa shtetësi në çfarëdolloj mënyre në kufijtë e territoreve ku i kërcënohet jeta ose liria e tij, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjeve të tij politike.

“Mbrojtja plotësuese” është formë mbrojtjeje që i jepet shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi, që nuk i përmbush kriteret për të fituar statusin e refugjatit dhe ka arsye serioze e të bazuara të mendohet se në rast të kthimit të tij në vendin e origjinës apo në rastin e personit pa shtetësi në vendbanimin e tij të zakonshëm të mëparshëm, ai rrezikon realisht të përballlet me cenime të rënda dhe nuk ka mundësi, apo për shkak të rrezikut të tillë nuk dëshiron të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi.

“Mbrojtje e përkohshme” është një procedurë e veçantë mbrojtjeje, e cila u siguron mbrojtje të menjëhershme dhe të përkohshme personave të shpërngulur në rastet e flukseve masive, të cilët nuk mund të kthehen në vendin e tyre të origjinës, në veçanti, nëse ekziston rreziku që sistemi i azilit të jetë i paaftë të procedojë me këtë fluks, pa

krijuar efekte të pafavorshme në funksionimin e tij efektiv, në interes të këtyre personave.

“Qendra e Pritjes për Azil” është struktura e caktuar për pranimin dhe akomodimin e kërkesve për mbrojtje ndërkombëtare.

“Qendrat Përkohshme të Pritjes në Kufi”: Një strukturë emergjente e vendosur afër kufirit, e dedikuar për pranimin, kontrollin fillestar, regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve bazë (ushqim, ujë, tualete, mburojë) migrantëve që hyjnë në territor në mënyrë të parregullt. Kjo qendër operon për një periudhë të kufizuar, derisa të përcaktohet rrugëtimi i mëtejshëm (deportim, trajtim ose referim për azil).

Flukse të përziera migratore: lëvizje komplekse të njerëzve që përfshijnë refugjatë, azilkërkes, viktimë të trafikimit, migrantë ekonomikë dhe kategoritë e tjera, të cilët udhëtojnë në të njëjtën rrugë apo në forma të ngjashme, shpesh në mënyrë të parregullt dhe me arsye të ndryshme migrimi.

SEKSIONI 4. Qëllimi

Ky plan synon të garantojë një përgjigje të koordinuar, efektive dhe gjithëpërfshirëse të gjithë institucioneve qendrore dhe vendore, për të përballuar çdo situatë të shkaktuar nga flukset e përziera migratore, të cilat mund të paraqiten në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Qëllimi është forcimi i kapaciteteve shtetërore për të menaxhuar në mënyrë efektive dhe të organizuar sfidat që vijnë nga lëvizjet masive të popullsisë, nëpërmjet një qasje të unifikuar ndër-institucionale, me vëmendje të shtuar tek mbrojtja e të drejtave të njeriut,

ndihma humanitare, kontrolli kufitar dhe ruajtja e rendit publik, si dhe siguria e shëndetit publik.

Institucionet përgjegjëse të përfshira, kanë detyrimin të hartojnë dhe zbatojnë planet e tyre sektoriale të veprimit, në përputhje me këtë **Plan Kontigjence** dhe me **Planin Kombëtar të Emergjencave Civile**.

SEKSIONI 5. Objektivat

Objektivi 1: Forcimi i kapaciteteve shtetërore për menaxhimin e krizave migratore, duke përfshirë sistemin e azilit dhe kontrollin kufitar.

Ky objektivi ka për qëllim zhvillimin e kapacitetit reagues gjithëpërfshirës në nivel kombëtar dhe lokal për të përballuar në mënyrë efektive flukset e papritura migratore. Duke synuar në këtë mënyrë përmirësimin e infrastrukturës pritëse, rritjen e

kapaciteteve njerëzore, si dhe rritjen e kapaciteteve logjistike dhe teknologjike. Gjithashtu, duke synuar fuqizimin e strukturave të kontrollit kufitar dhe të sistemit kombëtar të azilit, nëpërmjet konsolidimit dhe forcimit të mekanizmave të identifikimit dhe regjistrimit të menjëhershëm të individëve në kufi, realizimit të vlerësimeve fillestare të nevojave të tyre, si dhe garantimit të referimit në sistemin e azilit të atyre që shprehin nevojën për mbrojtje ndërkombëtare.

Objektivi 2: Sigurimi i pritjes, akomodimit, trajtimit dhe mbrojtjes së dinjitetit për migrantët, me fokus të veçantë tek grupet vulnerabël dhe azilkërkuesit.

Ky objektivi ka për qëllim garantimin e standardeve dinjitoze të trajtimit njerëzor për të gjithë ata individë që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë flukseve të përziera migratore, duke përfshirë azil kërkuesit dhe refugjatët. Duke synuar në këtë mënyrë krijimin e qendrave pritëse modulare dhe të përshtatshme, vendosjen e procedurave për trajtim të diferencuar për grupet më të cënueshme, sigurimin e aksesit në ndihmat humanitare, shërbimet sociale dhe shëndetësore, mbështetjen psikologjike dhe asistencën ligjore. Gjithashtu, ky objektivi synon forcimin e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse për vlerësimin dhe përpunimin e kërkesave për azil, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Objektivi 3: Sigurimi i menaxhimit efikas të kufijve.

Ky objektivi nxit përforcimin e kapaciteteve operative, koordinimin dhe ndërveprueshmërinë e institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e kufijve, me qëllim garantimin e kontrollit të sigurt, ligjor dhe efikas të kufijve të Republikës së Shqipërisë. Ky objektivi do të realizohet në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, prioritetet e sigurisë kombëtare dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Duke synuar zbatimin e qasjeve të bazuara në vlerësimin e riskut, forcimin e kapaciteteve identifikuese, përgjigjen e shpejtë, si dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve përkatëse, përgjegjëse për sigurinë e kufijve shqiptar.

Objektivi 4: Forcimi i koordinimit ndërinstitutional dhe bashkëpunimit me aktorët ndërkombëtar për menaxhimin gjithëpërfshirës të krizave migratore.

Ky objektiv ka për qëllim ngritjen e mekanizmave të qëndrueshëm për bashkërendimin institucional ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për menaxhimin e kufijve, sistemit të azilit, mbrojtjes civile, shëndetësisë si dhe rendit dhe sigurisë publike. Duke synuar në këtë mënyrë promovimin e partneritetit me organizatat ndërkombëtare të cilat ofrojnë mbështetje teknike dhe operacionale, si dhe garantimin e një përgjigje të koordinuar dhe efikase në të gjitha nivelet e strukturave shtetërore në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Objektivi 5: Zhvillimi i një strategjie të integruar dhe të besueshme në komunikimin publik, gjatë krizave migratore.

Ky objektiv ka për qëllim sigurimin e transmetimit të saktë dhe në kohë të informacionit ndaj publikut vendas dhe komunitetit ndërkombëtar, me qëllim parandalimin e përhapjes së panikut, keqinformimit dhe stigmatizimit të migrantëve. Duke synuar në këtë mënyrë ngritjen e një platforme të centralizuar komunikimi, trajnimit e zëdhënësve institucional, si dhe përgatitjen e materialeve informuese në disa gjuhë, duke përfshirë dhe informacionin mbi të drejtat e migrantëve dhe procedurat për azil në Republikën e Shqipërisë. Nëpërmjet një sistemi të tillë të mbledhjes, përgatitjes dhe transmetimit të informacionit synohet të garantohet transparenca, përfshirja dhe besimi reciprok gjatë gjithë procesit të menaxhimit të krizave migratore.

Objektivi 6: Garantimi i rendit publik dhe sigurisë kombëtare në përputhje me të drejtat e njeriut, nëpërmjet kontrollit efektiv të kufijve dhe menaxhimit të riskut.

Ky objektiv ka për qëllim ruajtjen e sigurisë kombëtare nëpërmjet shtimit të kontrollit kufitar, menaxhimit të hyrjeve dhe daljeve, identifikimit të migrantëve me rrezik potencial, si dhe zbatimit të masave parandaluese në zonat kufitare dhe qendrat pritëse. Duke synuar në këtë mënyrë mobilizimin e strukturave të sigurisë dhe inteligjencës, vlerësimin e rrezikut në kohë reale dhe krijimin e planeve të sigurisë për menaxhimin e situatave emergjente. Këto masat do të zbatohen në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes ndërkombëtare.

SEKSIONI 6. Parimet themelore

- **Përgjigje e koordinuar dhe e integruar:** Plani siguron një koordinim të ngushtë ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, duke integruar kapacitetet dhe burimet e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare për t'u përgjigjur në mënyrë efektive ndaj krizave migratore.
- **Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare:** Të gjitha masat dhe procedurat e përcaktuara në plan janë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, si dhe me angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.
- **Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe shëndetit të migrantëve:** Plani garanton mbrojtjen e të drejtave të njeriut për të gjithë migrantët, në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Duke synuar mbrojtjen e grupeve më të cënueshme si fëmijët, gratë, dhe individët me aftësi të kufizuara, si dhe duke siguruar akses të barabartë në shërbime shëndetësore dhe mbështetje sociale.
- **Përgatitje dhe Parandalim:** Ky plan shërben si një mjet efektiv për parandalimin dhe përgatitjen ndaj flukseve migratore, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve dhe burimeve të nevojshme për të ofruar përgjigje efikase në situata emergjente. I hartuar në përputhje me Strategjinë e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA), për përgatitjen dhe menaxhimin e krizave që thekson rëndësinë e krijimit të strukturave të konsoliduara për përballimin e flukseve të papritura dhe emergjencave.
- **Fleksibilitet:** Plani është dizajnuar për të ofruar fleksibilitet nëpërmjet mundësisë së ofrimit të përgjigjeve të shpejta dhe të përshtatshme ndaj ndryshimeve dinamike në situatat e flukseve të përziera migratore.
- **Pjesëmarrje dhe Transparencë:** Plani siguron një proces të hapur dhe transparent të implementimit duke përfshirë aktorë të ndryshëm si shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm.

- **Bashkëpunimi Ndërkombëtar:** Të gjitha masat e plani janë të orientuara drejt intensifikimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke përfshirë këtu agjencitë ndërkombëtare dhe shtetet fqinje për të menaxhuar flukset migratore, si dhe për të siguruar kthimin e sigurt të migrantëve të parregullt.

SEKSIONI 7. Planifikimi dhe përgatitja

7.1 Kuadri ligjor

- a. Ligji Nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile";
- b. Ligji Nr. 152/2015, datë 21.12.2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" ;
- c. Ligj Nr. 38/2019 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- d. Ligj Nr. 36/2024 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut";
- e. Ligj Nr. 82/2024 Për Policinë e Shtetit;
- f. Ligji Nr. 39/2025 " Për Kontrollin e Kufirit Shtetëror";
- g. Ligji Nr. 79/2021 "Për të huajt", të ndryshuar ;
- h. Ligj Nr. 22/2020 Për disa shtesa në ligjin nr.71/2016 "Për kontrollin kufitar";
- i. Ligji Nr. 10/2021 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë";
- j. Ligjin Nr. 157/2013, "Për masat kundër Financimit të Terrorizmit", të ndryshuar;
- k. Ligji Nr.10 107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;
- l. Ligji Nr. 10 383, datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;
- m. Ligji Nr. 10138, datë 11.05.2009 "Për shëndetin publik", të ndryshuar;

- n. Ligji Nr. 147/2014, "Për Shërbimet e Urgjencës Mjekësore";
- o. Ligj Nr. 84/2024 "Për miratimin e planit afatgjatë të zhvillimit të forcave të Armatosura 2024–2033";
- p. Ligj Nr.7978, datë 26.7.1995 "Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;
- q. Ligji Nr. 18/ 2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës";
- r. Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH";
- s. Ligji nr. 51, datë 03.07.2025 "Për rezervat materiale të shtetit"
- t. VKM Nr. 807, datë 28.12.2023, "Për Miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile";
- u. VKM nr. 923, datë 25.11.2020 "Për Funksionimin e Organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe Bashkëpunimin Ndërinstitucional i Institucioneve dhe të Strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile" ;
- v. VKM Nr. 241, datë 27.3.2013 "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor".

7.2 Analiza e situatës në Bashkimin Evropian dhe rajon

Fluksi jo-rajonal i migracionit që kalon në Ballkanin Perëndimor është ngushtë i lidhur me situatën në Mesdheun Lindor dhe për pasojë i ndikuar nga zhvillimet në vendet kyçe të origjinës dhe ato të tranzitit në lindje.

Një shkallë e lartë pasigurie shfaqet në vendet kryesore të origjinës dhe ato të tranzitit (si Afganistani, Pakistani, Irani, Siria, Libani dhe Gaza) të cilat vazhdojnë të mbeten shqetësim për lëvizjet e mundshme migratore drejt Bashkimit Evropian. Megjithatë, disa faktorë si rritja e kontrollit kufitar në vendet kryesore të tranzitit pranë zonave të paqëndrueshmërisë, forcimi i pranisë ushtarake në kontekstin e konflikteve dhe varfëria e përhapur, kanë kontribuar në parandalimin e një rritje të konsiderueshme të flukseve të migracionit të pakontrolluar drejt kufijve të jashtëm të BE-së.

Në fund të vitit 2024 dhe gjatë vitit 2025, periudhat e qeta tranzitore të nxitur nga komuniteti ndërkombëtar, kanë kontribuar në krijimin e një atmosfere përgjithësisht pozitive, duke lehtësuar në këtë mënyrë migracionin e parregullt nga zona e Lindjes së Mesme.

Flukset migratore në Mesdheun Lindor pësuar rritje përgjithësisht gjatë vitit 2024, të kryesuar nga flukset drejt Greqisë (përmes Turqisë drejt ishujve Egje, në një masë më të ulët drejt kufirit tokësor, gjithashtu nga Lindja e Libisë drejt Kretës), dhe në shifra më të ulëta drejt kufirit tokësor të Bullgarisë me Turqinë.

Migrantët të cilët mbërrijnë në kontinentin e Mesdheut Lindor zakonisht udhëtojnë drejt Ballkanit Perëndimor. Itineraret kryesore të migrimit përmes Ballkanit Perëndimor janë: Turqi–Greqi–Maqedonia e Veriut–Serbi–Bosnje dhe Hercegovina–Kroaci–Slloveni–Itali/Gjermani; dhe Turqi–Greqi–Maqedonia e Veriut–Serbi–Hungari, të cilat mbeten aktive duke krijuar flukse migratore drejt vendeve të BE-së. Në përgjithësi, numri i kalimeve të paligjshme të kufirit të identifikuar ose përpjekjet për t'u futur në mënyrë të paligjshme nga migrantët jo-rajonale për vitin 2023 ishin 178,000 dhe për vitin 2024 ishin 63,600, prej të cilave 61,300 ishin në kufijtë e gjelbër dhe 2,300 në pikat kryesore të kalimit kufitar (PKK).

Një tjetër mënyrë që emigrantët përdorin për të kaluar në vendet e BE-së, është keqpërdorimi i vizave të punës apo përdorimi i vizave fiktive të punës. Një pjesë e punëtorëve të kontraktuar nga bizneset vendase, kryesisht nga India, Nepali, Bangladeshi, Sri Lanka, Filipine dhe Pakistani, e përdorin Shqipërinë si urë-kalimi për në vendet e BE-së, duke abuzuar me vizat e punës. Keqpërdorimi i liberalizimit të vizave vazhdon të jetë një nga format më të përdorshme nga shtetasit turq (afërsisht 8,600) dhe në masë më të vogël nga nacionalitete të tjera si kinezët (rreth 1,050), mongolët (rreth 250) dhe rusët (100) të cilët përpiqen të kalojnë në mënyrë të paligjshme rajonin.

SENSITIVE – Releasable to WB-RAN

Total number of detections 2024 vs 2023

Mostly non-regional flow / pressure

Non-regional flows on the Eastern Mediterranean route

Direction of the arrow – general direction of the flow

Width of the arrow – indicative of the size of the flow

%

3 306 -96%

25 203 11%

1 755 -15%

3 104 -39%

436 -59%

6 193 -60%

112 81%

12 870 -48%

2 356 -44%

7 574 7%

54 466 33%

4 400 -65%

1 113 -73%

791 548%

1 564 74%

2 227 -9%

79 72%

42 88%

79 44%

27 50%

47 21%

113 25%

118 designations is without prejudice to positions on status, and is in line with UNHCR 1244 and the 167 System on the Kosovo declaration of independence.

FRONTEx

The standard handling instruction for SENSITIVE information is laid down in Decision of the Executive Director (No. R-ED-2023-60 on the implementing rules for marking and handling sensitive non-classified information

Frontex.eu

EUAA , Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (2024). "Tendencat dhe Profilizimi i Kërkesave për Azil, Përmbledhje për vitin 2024".

Raportet rajonale nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) theksojnë sfidat e vazhdueshme lidhur me kapacitetet e akomodimit, burimet njerëzore dhe logjistike, si dhe presionin mbi sistemet e pritjes dhe ofrimin e shërbimeve në vendet e tranzitit¹. Tendencat e përpjekjeve të përsëritura për të hyrë, veçanërisht nga migruesit që më parë janë refuzuar ose janë kthyer, janë rritur ndjeshëm gjatë vitit 2024².

7.3 Analiza e situatës në Shqipëri, menaxhimi i kufirit

7.3.1 Të huaj të parregullt të ndaluar

Në rastin e Shqipërisë, flukset migratore janë të përqendruara në kufirin jugor me Greqinë. Migrantët priren të kalojnë drejt kufirit me Malin e Zi ose Kosovën, me qëllim hyrjen në territoret e Bashkimit Evropian. Kjo ka bërë që Shqipëria të konsiderohet gjithnjë e më shumë një qendër strategjike për menaxhimin rajonal të migracionit³.

Gjatë periudhës 2022–2024, Shqipëria shënoi një ulje të ndjeshme prej 87.4% në numrin total të shtetasve të huaj të parregullt të ndaluar, duke reflektuar ndryshime të konsiderueshme në rrugët dhe intensitetin e lëvizjeve të parregullta përmes territorit shqiptar.

Ndalimet në pikat e kalimit kufitar (PKK) ranë ndjeshëm nga 6,632 në vitin 2022 në vetëm 23 në vitin 2024, ndërsa ndalimet në zonat kufitare u rritën ndjeshëm në 2023, duke kaluar nga 352 në 4,169 raste, përpara se të uleshin sërish në 1,254 në vitin 2024. Kjo rritje e përkohshme tregon intensifikim të përpjekjeve për kalime të paligjshme.

¹ IOM (2024). Statistikat Rajonale për Ballkanin Perëndimor – Raporti për Tremujorin I 2024, Zyra Koordinuese Rajonale, Vjenë.

² EUAA (2024). Analiza mbi Tentativat e Përsëritura dhe Presionin Operacional – Q2 2024.

³ IOM Albania (2023). Raport Kombëtar për Trendet dhe Sfidat e Migracionit në Shqipëri. Tiranë, Shqipëri.

Ndalimet në territor kanë shënuar një rënie progresive (nga 5,232 në 2022 në 263 në 2024), çka sugjeron përmirësim të kapaciteteve të kontrollit kufitar dhe zbulim më të hershëm të hyrjeve të paligjshme.

Tabela 1. Të huajt e ndaluar (2022–2024)

Vendndodhja	2022	2023	2024
Zona kufitare	352	4169	1254
Pika kalimi kufitar	6632	72	23
Në territor	5232	2389	263
Gjithsej	12,216	6630	1540

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

7.3.2 Zonat kryesore të presionit migrator

Analiza gjeografike tregon se kufiri me Greqinë ka qenë vazhdimisht zonë me intensitet më të lartë. Në vitin 2022, ky kufi përbënte mbi 84% të totalit të ndalimeve (10,281 raste). Në vitin 2024, ndonëse ndalimet u ulën ndjeshëm në të gjitha zonat, kufiri me Greqinë mbeti segmenti më kritik, duke përbërë sërish shumicën relative të rasteve. Kufiri me Malin e Zi dhe Kosovën ka shfaqur një rënie graduale, por ruan rëndësinë strategjike, si një segment tranzit drejt rajonit dhe Bashkimit Evropian. Kufiri detar, ndonëse më pak i ngarkuar, kërkon monitorim të vazhdueshëm, sidomos për shkak të rritjes së përkohshme të shifrave në vitin 2023.

Tabela 2. Të huajt e ndaluar sipas zonës (2022–2024)

Zona	2022	2023	2024
Kufiri me Greqinë	10,281	6,104	1,278
Kufiri me Malin e Zi/Kosovën	1,347	372	190
Brenda territorit	519	154	72
Kufiri detar	69	103	21

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

7.3.3 Profilizimi i migrantëve të ndaluar sipas shtetësisë

Në vitin 2022, grupet më të mëdha të të huajve të parregullt të ndaluar ishin nga Siria, Bangladeshi dhe Afganistani. Nga viti 2023 deri në vitin 2024 ka patur ulje të ndjeshme të numrave nga këto vende, me një zhvendosje drejt shtetasve egjiptianë dhe nepalezë. Ky ndryshim reflekton mbi diversifikimin e rrugëve të origjinës dhe ndoshta ndryshim në rrjetet e trafikimit apo kanalet e migracionit të parregullt që përdoren.

Tabela 3. Të ndaluar sipas shtetësisë

Shtetësia	2022	2023	2024
Sirianë	5,314	1,305	336
Bangladeshas	1,564	792	-
Afganë	1,325	1,610	165
Pakistanezë	1,114	969	287
Somalezë	574	-	-
Egjiptianë	-	-	187
Nepalezë	-	-	140

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

7.3.4 Refuzimet në hyrje

Refuzimet në kufijtë ajror dominonin në vitin 2022 me një total prej (2,166 rastesh), por pësuan një rënie me 76.4% në vitin 2024. Refuzimet në hyrje nga kufijtë tokësor, ndonëse më pak të rëndësishëm në fillim, pësuan rritje të vazhdueshme, nga 11 raste në vitin 2022 në 174 raste në vitin 2024. Ky fakt tregon shtimin e përpjekjeve për të hyrë në territor përmes kufijve tokësor dhe nevojën për forcim të kontrolleve kufitare në këto pika.

Tabela 4. Refuzimet në hyrje sipas PKK

Lloji i PKK-së	2022	2023	2024
Tokësor	11	148	174
Ajror	2,166	647	510
Detar	7	20	12
Gjithsej	2,148	816	696

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Në vitin 2022, mungesa e mjeteve financiare ishte shkaku kryesor i refuzimit të hyrjes (1,806 raste). Në vitin 2023 dhe vitin 2024, problemet me dokumentacionin (të tilla si: dokumente të pavlefshme, mungesë vize) u bënë shkaqet kryesore të refuzimit të hyrjes, duke tejkaluar arsyet financiare. Ndërsa tejkalimi i afatit të qëndrimit i cili përbënte një shkak domethënës në vitin 2022, u eliminua si arsye për dy vitet e ardhshme, si rezultat i përmirësimeve në menaxhimin e të dhënave dhe sistemit të kontrollit të qëndrimeve.

Tabela 5. Motivi i Refuzimit

Motivi i Refuzimit	2022	2023	2024
Dokumentacion i pavlefshëm / Mungesë vize	35	133	159
Nuk ka vizë	36	173	149
Tejkalim afati qëndrimi	236	0	0
Njoftim në sistem	0	0	0
Mungesë e mjeteve financiare	1,806	308	369
Nuk plotëson kushtet e qëndrimit në RSH	35	8	19
Të tjera	2,148	74	120

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracioni

7.4 Mbrojtja Ndërkombëtare, Azili

7.4.1 Lloji i mbrojtjes 2022-2024

Referuar të dhënave të Autoritetit Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët, gjatë periudhës 2022–2024 nuk është regjistruar asnjë rast dëbimi i shtetasve që kanë paraqitur kërkesë për azil ose kanë përfituar ndonjë formë mbrojtjeje ndërkombëtare. Gjatë kësaj periudhe mbrojtja e përkohshme ka qenë forma mbizotëruese e mbrojtjes ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë. Numri i rasteve ka shënuar një rritje të ndjeshme, nga 544 raste në vitin 2022, në 1,981 raste në vitin 2023, duke arritur në 4,079 raste në vitin 2024. Kjo rritje në shifra lidhet drejtpërdrejt me flukset e shtetasve afganë që qëndrojnë përkohësisht në Republikën e Shqipërisë, bazuar në vendime të Këshillit të Ministrave.

Për vitin 2025, një total prej 549 shtetasish afganë qëndrojnë në Shqipëri dhe trajtohen në përputhje me standardet e mbrojtjes së përkohshme. Gjatë së njëjtës periudhë, numri i individëve që kanë përfituar Mbrojtje të Përkohshme ka mbetur relativisht i qëndrueshëm. Përfituesit janë shtetas të këtyre kombësive:

Viti	Kombësia			
2022	2 shtetas sirianë	6 shtetas egjiptianë	10 shtetas afganë	3 shtetas tunizianë
2023	5 shtetas irakianë	2 shtetas palestinezë	2 shtetas sirianë	1 shtetas egjiptian
2024	14 shtetas sirianë kanë përfituar Mbrojtje të Përkohshme.			

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme, Autoriteti Kombëtar i Azilit

Statusi i refugjatit është dhënë vetëm një herë, në vitin 2024, për një shtetas kamboxhian.

Referuar aplikimeve për Mbrojtje të Përkohshme, në total 9,470 shtetas afganë kanë tërhequr aplikimet e tyre. Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët ka lëshuar 7,565 vendime për përfundimin e Mbrojtjes së Përkohshme. Aktualisht, 549 shtetas afganë kanë një vendim aktiv për Mbrojtje të Përkohshme në Republikën e Shqipërisë.

Për periudhën 2022–2024, në Shqipëri janë regjistruar gjithsej 490 kërkesa për Mbrojtje Ndërkombëtare (MN), me tendenca të paqëndrueshme vjetore:

Në vitin 2022, janë paraqitur 125 kërkesa;

Në vitin 2023, janë paraqitur 261 kërkesa;

Në vitin 2024, janë paraqitur 104 kërkesa.

Gjatë periudhës 2022–2024, numri i personave që kanë përfituar një nga format e mbrojtjes është rritur ndjeshëm.

Në vitin 2022, gjithsej 568 persona kanë përfituar një formë mbrojtjeje, ku 544 kanë përfituar Mbrojtje të Përkohshme, ndërsa 24 kanë përfituar Mbrojtje Plotësuese.

Në vitin 2023, numri total i përfituesve është rritur në 1,995, ku Mbrojtja e Përkohshme përbën sërish shumicën dërrmuese (1,981 raste), ndërsa 14 individë kanë përfituar Mbrojtje Plotësuese.

Në vitin 2024, numri i përgjithshëm i përfituesve është rritur në 4,096, ku 4,079 raste janë me Mbrojtje të Përkohshme, 16 raste me Mbrojtje Plotësuese dhe 1 rast i dhënies së Statusit të Refugjatit.

Gjatë gjithë kësaj periudhe, Mbrojtja e Përkohshme ka qenë forma mbizotëruese e mbrojtjes në Republikën e Shqipërisë, ndërkohë që Mbrojtja Plotësuese ka qenë në nivele relativisht të qëndrueshme, dhe dhënia e Statusit të Refugjatit ka qenë më e rrallë.

Tabela 6. Dinamika e mbrojtjes ndërkombëtare (2022–2024)

Lloji i mbrojtjes	2022	2023	2024
Refugjat	0	0	1
Mbrojtje plotësuese	24	14	16
Mbrojtje e përkohshme	544	1981	4079
Gjithsej	568	1995	4096

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme, Autoriteti Kombëtar i Azilit

Në lidhje me vendimet përfundimtare në procedurat e Mbrojtjes Ndërkombëtare, gjatë vitit 2022 janë regjistruar gjithsej 36 vendime, të cilat janë ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet pezullimeve dhe përfundimeve të procedurave.

Viti 2023 shënoi një rënie të ndjeshme të numrit të vendimeve (14 gjithsej), me dy raste refuzimi. Në vitin 2024, shifrat (për vendimet) u rritën në 28 dhe për herë të parë u shfaqën raste të humbjes së statusit (6 raste). Gjatë periudhës trevjeçare, pezullimi i procedurës ka qenë forma më e shpeshtë e përfundimit të saj.

Tabela 7. Vendimet

Lloji i vendimit	2022	2023	2024
Refuzime	0	2	3
Revokime	0	0	0
Pushime	18	12	10
Ndërprerje	18	0	9
Humbje statusi	0	0	6
Gjithsej	36	14	28

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme, Autoriteti Kombëtar i Azilit

7.4.2 Sistemi i pritjes

Kapacitetet pritëse të Shqipërisë për përballimin e flukseve migratore janë të përqendruara në disa zona specifike të vendit, duke mos ofruar në këtë mënyrë një mbulim të balancuar territorial. Në aspektin gjeografik, strukturat pritëse janë të përqendruara në jug dhe qendër të vendit (Tiranë, Gjirokastrë, Korçë), ndërkohë që zonat veriore mbeten të pambuluara me struktura specifike për menaxhimin e flukseve migratore. Kjo përbën një hendek thelbësor duke marrë parasysh se kufijtë me Kosovën dhe Malin e Zi, përbëjnë pika potenciale hyrjesh të papritura në rast të një krize rajonale apo ndërkombëtare.

Në qendër të këtij sistemi qëndron **Qendra e Pritjes për Azilin në Tiranë**, e cila është struktura e vetme për akomodimin e personave të cilët kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare.

Me një kapacitet prej 250 personash dhe e rinovuar në vitin 2022 në përputhje me standardet ndërkombëtare, kjo qendër ofron kushtet bazë për jetesë dhe mbështetje për ri-integrimin e personave të cilët fitojnë statusin e mbrojtjes. Kjo Qendër funksionon në varësi të Ministrit të Punëve të Brendshme dhe bashkëpunon ngushtësisht me organizata ndërkombëtare, kryesisht UNHCR.

Në Republikën e Shqipërisë, ekzistojnë dhe funksionojnë dhe qendrat e regjistrimit dhe

akomodimit të përkohshëm, të vendosura në jug të vendit: në Gërhot dhe Kakavijë të Gjirokastrës, dhe në Kapshticë të Korçës. Këto qendra funksionojnë për ndalimin dhe përzgjedhjen e migrantëve të parregullt (procesi screening), me një kohëzgjatje maksimale akomodimi prej 10 orësh. Këto Qendra luajnë një rol të rëndësishëm në procesin fillestar të menaxhimit të hyrjeve në territorin shqiptar.

Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024–2026, deri në vitin 2026 do të ngrihet një Qendër Pritëse për Fëmijët e Huaj të Pashoqëruar.

Kjo qendër do të ofrojë strehim, si dhe të gjitha shërbimet e nevojshme psiko-sociale dhe mjekësore, për deri në **26 fëmijë**. Qendra do të financohet nga Bashkimi Evropian dhe do të zbatohet në partneritet të plotë me organizata ndërkombëtare si IOM dhe UNHCR.

Deri në bërjen funksionale të kësaj Qendre, **Ministria e Punëve të Brendshme** dhe **Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale** do të bashkëpunojnë ngushtësisë për të ofruar shërbime për këtë kategori nëpërmjet një Organizate Jo-Qeveritare të specializuar, bazuar në **Procedurat Standarde të Operimit (SOP)**.

Tabela 8. Qendrat Pritëse

Qendra	Vendndodhja	Kapaciteti	Kontatime
Gerhot	Gjirokastrë	60 persona	Zonë kufitare jugore
Kakavijë	Gjirokastrë	32 persona	Ambient 10-orësh
Kashticë (Kapshticë)	Korçë	118 persona (110 + 8 në PKK)	Shërbim për përzgjedhje të shpejtë

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Ndërkohë, e vetmja qendër e mbyllur për imigrantët e parregullt ndodhet në Karreç, nën menaxhimin e Policisë së Shtetit, me një kapacitet prej 100 shtretërish. Kjo strukturë përdoret për mbajtjen e përkohshme të të huajve që ndalohen deri në përfundimin e procedurave për identifikim ose dëbim.

7.4.3 Kapacitetet

Kapacitetet ekzistuese ndërinstitutionale për përballimin e flukseve migratore për një reagim/ përgjigje të koordinuar në rast emergjence.

Komponenti	Institucioni përgjegjës	Kapacitetet ekzistuese (burime njerëzore dhe	Nevojat në emergjencë	Gap/Nevojë Prioritare
------------	----------------------------	--	--------------------------	--------------------------

		infrastrukturë)		
Regjistrimi dhe kontrolli kufitar	DKM PSH	613 punonjës policie në strukturat vendore të policisë së kufirit dhe migracionit, të cilët kryejnë regjistrimin, përzgjedhjen dhe mbikëqyrjen.	300 punonjës shtesë nga institucionet e përfshira në proces. FA dhe Partnerët Ndërkombëtar.	Trajnim; Logjistikë: automjete, pajisje kompjuterike, materiale zyre, etj.
Akomodimi i përkohshëm	DKM	Strehim i përkohshëm për 386 persona (kapacitet ekzistues).	Strehim i përkohshëm për 900 persona.	Krijimi i 3 qendrave emergjente të strehimit (kampe në qarqet Gjirokastrë, Korçë dhe Vlorë).
Strehimi në Qendrën e Pritjes për Azilkërkues (QPA)	MPB	Burimet njerëzore: 15 punonjës (3 në Sektorin e Mbështetjes së Azilkërkuesve). Kapaciteti i shtretërve: 220	Shtim i stafit me 7 punonjës: 1 përkthyes, 2 punonjës socialë, 1 punonjës pastrimi, 1 punonjës mirëmbajtjeje, 1 psikolog, 1 infermier.	Shtim i stafit, trajnim i stafit, logjistikë shtesë.

Mbrojtja Ndërkombëtare (Regjistrim, Shqyrtim/Intervistat Personale dhe dhënia e Vendimit.	MPB	3 zyrtar/ specialist çështjesh; 1 Shef Sektori – menaxher dhe zyrtar çështjesh; Ambientet kryesore të Autoritetit të Azilit në qendër të qytetit; Arkiv i sigurt për ruajtjen e dosjeve dhe të dhënave personale; Pajisje IT (kompjuter, printer, sistem menaxhimi çështjesh); Sallë takimesh për koordinim dhe trajnim.	2 zyra të përkohshme ose hapësira për stafin shtesë; 2 zyrtarë COI; Dhoma të posaçme për intervistat me pajisjet e nevojshme; Dhoma të lëvizshme ose të parapërgatitura për intervista; Shtimi i sigurisë për ruajtjen e dosjeve dhe provave; Pajisje IT rezervë (laptop, tablet, printer portativ); Nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë për sigurimin e	2 zyrtar/ specialist shtesë çështjesh për të përballuar rritjen e numrit të rasteve gjatë emergjencave; Staf i specializuar për grupet e cenueshme (p.sh., të miturit, viktimat e trafikimit); Përkthyes të dedikuar për gjuhë të rralla – FA dhe Partnerët Ndërkombëtar; Krijimi i një regjistri kombëtar të përkthyesve të kualifikuar për procedurat e azilit – FA dhe Partnerët Ndërkombëtar; Dhoma shtesë për intervista për
--	-----	--	---	--

			përkthyesve të licencuar gjyqësorë, përveç përkthyesve aktualë të angazhuar nga RMSA; Qasje në pajisje për përkthim për gjuhët më të shpeshta; Mjetet e transportit për stafin për në/drejt vendndodhjeve në terren.	të shmangur vonesat gjatë periudhave të ngarkuara – FA dhe Partnerët Ndërkombëtar; Sistem i sigurt digjital për arkivim dhe rikthim më të shpejtë të të dhënave; Njësi mobile ose struktura të përkohshme për kapacitet shtesë – FA dhe Partnerët Ndërkombëtar; Server rezervë IT dhe sisteme sigurie të të dhënave për të garantuar vazhdimësinë gjatë ndërprerjeve – FA dhe Partnerët Ndërkombëtarë; Përmirësim i ambienteve të
--	--	--	---	--

				pritjes për aplikuesit-FA dhe Partnerët Ndërkombëtar.
Shërbimet shëndetësore	MSHMS	Institucionet shëndetësore lokale dhe rajonale që zbatojnë sistemin e referimit.	36 punonjës mjekësorë dhe 6 epidemiologë; 3 autoambulanca në dispozicion për referime emergjente.	Trajnim i stafit të institucioneve shëndetësore spitalore për trajtimin e migrantëve, me fokus në njohjen e faktorëve social, gjuhësor dhe kulturor që ndikojnë në qasjen dhe përvojën e migrantëve me shërbimet shëndetësore; 3 dhoma të dedikuara për veprimtari mjekësore (1 për çdo qendër); Logjistikë: medikamente

				dhe furnizime mjekësore për 3 qendra të përkohshme emergjente pritjeje.
Shërbimet sociale	MSHMS ASHMDF SHSSH OJQ Bashkitë	24 punonjës psiko-social(PMF) nga tre bashki: Gjirokastrë (7), Vlorë (10), Korçë (7) + 3 punonjës psiko-social shtesë – gjithsej 27 punonjës psiko-social.	Në kushte krize kërkohen gjithsej 66 punonjës psikosocial; aktualisht janë në dispozicion 27, duke lënë një mungesë prej 39 punonjësish (23 punonjës socialë dhe 16 psikologë).	Shtim i stafit dhe trajnimet, sipas përkohshme të planifikimit); Rritje e kapacitetit të shtretërve në 2 qendra kombëtare për viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe në 3 strehëza të mbështetura nga FS, të dedikuara ekskluzivisht për rastet që kanë përfituar statusin VT/VMT.

7.5 Treguesit paralajmërues të hershëm dhe pragjet përkatëse
Treguesi i paralajmërimit të hershëm dhe pragjet

		Vlera e pranueshme SKENARI JESHIL	Pragu për thirrjen e masave parandaluese SKENARI I VERDHË	Pragu për thirrjen e masave që përmbajnë SKENARI PORTOKAL	Pragu për thirrjen e përgjigjes ndaj një krize SKENARI I KUQ
Menaxhimi i Kufirit/ Departamenti për Kufirin dhe Migracionin					
1.	Numri i imigrantëve të parregullt të kapur në javë	100	200	375	700
2.	Numri i imigrantëve të parregullt të kapur në kufirin tokësor me Maqedoninë e Veriut, në javë.	2	4	8	16
3.	Numri i imigrantëve të parregullt të kapur në kufirin tokësor me Malin e Zi, në javë.	29	58	105	200

4.	Numri i imigrantëve të parregullt të kapur në kufirin tokësor me Greqinë, në javë.	53	104	194	378
5.	Numri i imigrantëve të parregullt të kapur në kufirin tokësor me Kosovën, në javë.	4	10	20	30
6.	Numri i imigrantëve të parregullt të kapur në kufirin detar, në javë.	2	4	8	16
7.	Numri i migrantëve të parregullt të kapur në territor, në javë.	10	20	40	60
8.	Numri i refuzimeve të hyrjes në javë.	15	25	45	110
9.	Numri i migrantëve të parregullt që aplikojnë për azil në javë.	20	40	75	140
10.	Përqindja e të miturve të huaj të pashoqëruar në javë	4%	4%	4%	4%

Pritja

1	Numri i migrantëve në nevojë për pritje/akomodim, në javë.	100	200	375	700
2	Numri i migrantëve që akomodohen në Qendrat e Përkohshme të Pritjes për Migrantë, në javë.	100	200	375	700
3	Numri i imigrantëve që vendosen në Qendrën e Mbyllur për të Huajt, në javë.	6	10	15	25+
4	Numri i azilkërkuesve që vendosen në Qendrën Pritëse të Azilit (QPA), në javë.	20	40	75	250 +
5.	Ditët mesatare të qëndrimit në QPA	10	20	40	60

Azili					
1	Numri i aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, në javë.	5	10	30	60
2	Numri i vendimeve për kërkesën për azil (intervistë personale + vendim) i hartuar në javë.	2	4	12	20-25

SEKSIONI 8. Qeverisja – reagimi, koordinimi dhe menaxhimi i emergjencave në flukse të papritura migratore

Përballja me flukse të papritura migratore kërkon një kuadër të fortë qeverisës dhe një sistem të mirë-koordinuar ndërinstytucional, të aftë për të garantuar një përgjigje të shpejtë dhe gjithëpërfshirëse, të bazuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Plani Ndërinstytucional për Menaxhimin e Flukseve Masive Migratore në Shqipëri është krijuar mbi parimet e **ndarjes së qartë të përgjegjësisë, udhëheqjes së qëndrueshme qendrore, dhe bashkëpunimit të ngushtë ndërkombëtar dhe vendor.**

8.1 Kuadri Institucional dhe funksionet kryesore

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është autoriteti udhëheqës për menaxhimin e kufijve në procesin e përpunimit të të dhënave për regjistrimin e migrantëve dhe azilkërkuesve. Nëpërmjet garantimit të funksionimit të strukturave në pikat hyrëse, koordinon identifikimin e rasteve që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare dhe drejton shkëmbimin ndërinstytucional të informacionit operacional me të gjithë institucionet që janë përgjegjëse për zbatimin e Planit të Kontigjencës. Nëpërmjet **Drejtorisë së**

Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, MPB siguron ruajtjen e rendit publik, koordinon menaxhimin e flukseve migratore në kufi dhe brenda territorit, si dhe transmeton informacionin tek të gjithë aktorët përkatës dhe publikut të gjerë. Po ashtu, koordinon dhe drejton procesin e azil kërkimit, mbrojtjes ndërkombëtare dhe akomodimin në Qendrën e Pritjes për Azil, të migrantëve kërkues të mbrojtjes ndërkombëtare.

Ministria e Punëve të Brendshme, nëpërmjet **Ministrit të Punëve të Brendshme** aktivizon skenarin portokalli dhe skenarin e kuq, harton urdhrin e kryeministrit për ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale, Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Krizës Migratore (QKKM), si dhe Task-Forcën Operacionale Vendore. MPB është gjithashtu përgjegjëse për organizimin operacional dhe logjistik të funksionimit të QKKM.

Ministria e Mbrojtjes (MB) nëpërmjet **Forcave të Armatosura (FA) dhe Drejtorisë së Rezervave Materiale të Shtetit**, luan një rol kyç në mbështetjen logjistike dhe humanitare të operacioneve, gjatë aktivizimit të skenarit portokalli dhe skenarit të kuq duke mbështetur në:

- Ngritjen e strukturave të përkohshme të strehimit (tenda, kontejnerë, njësi mobile/të lëvizshme) pranë zonave kufitare apo rajoneve pritëse;
- Transportin dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare, duke përfshirë dhe ndihmat ushqimore dhe jo-ushqimore, nëpërmjet kapaciteteve logjistike ushtarake, në rastet e mungesës së kapaciteteve civile;
- Pjesëmarrjen në operacione sigurie, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, për mbrojtjen e perimetrit në kampet e përpunimit/strehimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Mobilizimin e kapaciteteve rezervë të emergjencës, duke përfshirë depozitat/depot e ndihmave dhe mbështetjen mjekësore në terren, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS).

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) ushtron autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të

riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe koordinon në mënyrë të përqendruar shpërndarjen e kapaciteteve logjistike dhe njerëzore, të caktuara për përballimin e emergjencave civile apo të fatkeqësive.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS) ka një rol të rëndësishëm në planifikimin dhe koordinimin e përgjigjes shëndetësore ndaj flukseve migratore. Nëpërmjet sigurimit të shërbimeve shëndetësore bazë dhe ato të urgjencës për migrantët, refugjatët dhe azilkërkuesit, si dhe mbikëqyrë epidemiologjinë dhe menaxhimin e ngjarjeve epidemiologjike në flukset migratore, sipas kuadrit rregullator në fuqi, nëpërmjet strukturave të saj (OSHKSH, QKUM, ISHP, ISHSH).

Në fushën e mbrojtjes sociale, MSHMS-ja luan një rol qendror në hartimin dhe koordinimin e politikave për ofrimin e kujdesit social ndaj grupeve vulnerabël brenda flukseve migratore, sipas përcaktimeve të ligjit në fuqi të shërbimeve sociale dhe standardeve të shërbimeve sociale. Përfitojnë shërbime shtetasit e huaj me leje qëndrimi në Shqipëri, vetëm në rastet kur një i huaj ka marrë statusin e azilit, apo që gëzon mbrojtje ndërkombëtare me vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

Menaxhimi i suksesshëm i flukseve migratore kërkon pjesëmarrjen aktive të:

- **Bashkive**, në ofrimin e shërbimeve sociale, orientimin e komuniteteve vendore dhe aktivizimin e strukturave emergjente në nivel vendor;
- **Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC)**, në ofrimin e ndihmës ligjore, psikologjike dhe sociale, veçanërisht për grupet vulnerabël;
- **Organizatave ndërkombëtare**, si IOM, UNHCR, UNICEF, OBSH në mbështetjen e operacioneve në terren, ofrimin e ndihma teknike dhe materiale, si dhe në mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe azilkërkuesve.

8.2. Mekanizmi i koordinimit dhe komunikimit

Në kuadër të Planit të Kontigjencës për Menaxhimin e Flukseve Migratore, për të garantuar një përgjigje të koordinuar dhe të përshkallëzuar në rast se treguesit

tejkalojnë skenarin e verdhë dhe aktivizojnë skenarin portokalli, parashikohet aktivizimi i Task-Forcës Ndërinstitucionale për Menaxhimin e Flukseve Migratore, Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Krizës Migratore dhe Task-Forcës Operacionale Vendore (TFOV), me urdhër të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

Task-Forca Ndërinstitucionale përfaqëson një mekanizëm të nivelit të lartë vendimmarrës, i cili drejtohet nga Ministri i Punëve të Brendshme dhe ka në përbërje anëtarë, si më poshtë:

- Ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Ministri i Financave
- Ministri i Mbrojtjes
- Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor
- Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit

Kjo Task- Forcë përbën organin kryesor strategjik që mbikëqyrë dhe udhëheq përgjigjen në situatat e përshkallëzuara, nga skenari portokalli në skenarin e kuq, duke garantuar ndërveprim të drejtpërdrejtë ndërmjet institucioneve vendimmarrëse dhe strukturave zbatuese në terren.

Task-Forca mbështetet nga Sekretariati teknik, në përbërjen e të cilit janë përfaqësues teknik nga të gjitha institucionet e përfshira, si dhe raporton në mënyrë periodike, çdo javë tek Kryeministri i Republikës së Shqipërisë.

Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Krizës Migratore (QKKM) është parashikuar për t'u ngritur në kuadër të skenarit portokalli dhe do të funksionojë si një strukturë operacionale e përkohshme, e vendosur pranë Ministrisë së Brendshme, me një rol kyç në koordinimin taktik dhe menaxhimin e përditshëm të situatës së krijuar nga flukset e përshkallëzuara migratore.

Qendra drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ose nga Drejtori i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, në varësi të natyrës dhe intensitetit të situatës migratore. Në përbërje të Qendrës, janë dhe nëpunësit e nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues të nominuar nga Ministrat përkatës, anëtarë të Task-Forcës Ndërinstitucionale, si dhe do të ftohen dhe partnerët ndërkombëtar mbështetës në këtë proces.

Qendra ka për detyrë të menaxhojë dhe koordinojë në kohë reale përgjigjen institucionale, të monitorojë lëvizjen dhe shpërndarjen e migrantëve, të mbikëqyrë kapacitetet e akomodimit dhe trajtimit të migrantëve, të siguroj transmetimin dhe shpërndarjen e informacionit ndërmjet institucioneve, si dhe të identifikojë nevojat për ndërhyrje të menjëhershme logjistike apo njerëzore.

Qendra përgatit dhe transmeton raporte operacionale çdo 24 orë ose sipas nevojës, pranë Task-Forcën Ndërinstitucionale, duke e informuar atë për situatën në terren, problemet, nevojat dhe progresin e masave të ndërmarra. Kjo marrëdhënie dinamike ndërmjet Qendrës dhe Task-Forcës siguron që vendimmarrja strategjike në nivel të lartë të mbështetet në të dhëna të sakta, të gjeneruara në terren në kohë reale, si dhe mundëson mobilizimin e koordinuar të të gjitha burimeve për menaxhimin efektiv të krizës migratore.

Qendra garanton shkëmbimin në kohë reale të informacionit dhe bashkëpunimin e menjëhershëm me të gjitha autoritetet kombëtare dhe lokale përgjegjëse për mbikëqyrjen e kufijve në vend me qendrat kombëtare të koordinimit të vendeve të tjera, si dhe me Agjencinë Evropiane të Kufirit dhe Rojeve Bregdetare. Ajo kontribuon në vlerësimin e rregullt të ndikimeve kombëtare të aktiviteteve të mbikëqyrjes së kufijve, si dhe përgatit dhe menaxhon raporte mbi situatën e sigurisë së kufirit në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian, të cilat mund të kenë ndikim potencial mbi sigurinë e kufirit kombëtar.

Gjithashtu, Qendra mbështet planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes së kufijve, koordinon zbatimin e sistemit kombëtar të mbikëqyrjes së kufijve, dhe

kontribuon në vlerësimin e vazhdueshëm të efekteve të mbikëqyrjes së kufijve në nivel kombëtar.

Task-Forcat Operacionale Vendore për Menaxhimin e Flukseve Migratore

Me aktivizimin e Task-Forcës Ndërinstitucionale, në të njëjtën kohë aktivizohen edhe Task-Forcat operacionale Vendore, për Menaxhimin e Flukseve Migratore, të cilat funksionojnë në nivel qarku nën drejtimin e Prefektit.

Task-Forca Operacionale Vendore, përbën mekanizmin kryesor të koordinimit në nivel lokal dhe ngarkohet me:


- Zbatimin e masave të planifikuara në nivel vendor, në përputhje me Planin e Kontigjencës dhe udhëzimet përkatëse të nivelit qendror;
- Koordinimin ndërinstitucional dhe ndërsektorial, ndërmjet strukturave të pushtetit vendor, institucioneve shtetërore lokale dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në menaxhimin e situatës së krijuar nga flukset migratore;
- Sigurimin e menaxhimit efektiv në terren, nëpërmjet mbikëqyrjes së zbatimit të detyrave dhe ndërhyrjeve, në përputhje me udhëzimet e Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Krizës Migratore dhe vendimmarrjet e Task-Forcës Ndërinstitucionale.

Task-Forca Vendore për Menaxhimin e Flukseve Migratore përbëhet nga përfaqësues të nivelit drejtues të institucioneve kryesore në nivel qarku, duke përfshirë:

- Kryetarët e Bashkive në territorin e qarkut
- Drejtori Vendor i Policisë së Shtetit
- Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Njësitë vendore të kujdesit shëndetësor
- Qendra Rajonale e Mbrojtjes Civile
- Drejtori Rajonal i Shërbimeve Social Shtetëror
- Drejtori i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionit

Task-Forca Operacionale Vendore zhvillon takime periodike, gjatë periudhës së emergjencës dhe raporton çdo 24 orë pranë QKKM mbi ecurinë e zbatimit të masave, si dhe rekomandon nevoja specifike për mbështetje shtesë, bazuar në vlerësimet e situatës në terren.

8.3 Mekanizmi i koordinimit dhe komunikimit në skenarin Portokalli dhe të Kuq



8.4 Monitorimi i treguesve të hershëm, pragjet dhe aktivizimi i skenarëve

Nivelet e Skenarëve	Kush monitoro?	Kush Vlerëson?	Kush ndërmerr veprime të menjëhershme?	Kush raporton për arritjen e nivelit të skenarit?	Kush aktivizon mekanizmi ?	Kush ekzekuton veprimet pas aktivizimit të mekanizmit ?	Kush raporton mbi rezultatet?
Jeshil (Normal)	Sektori i Analizës së Riskut dhe Statistikave (DKM)	Drejtori i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin	– (Pa veprime shtesë, vetëm monitorim)	Drejtori i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin	– (Asnjë mekanizëm nuk është aktivizuar)	– (Asnjë mekanizëm nuk është aktivizuar)	– (Nuk ka raportim formal të rezultateve ; vazhdon monitorimi i rregullt)
I Verdhë (Masa Parandaluese dhe Kontrolluese)	Sektori i Analizës së Riskut dhe Statistikave (DKM)	Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit	Departamenti i Kufirit dhe Migracionit / Njësitë teknike të Ministrisë së Punëve të Brendshme	Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit	Nivel i lartë udhëheqës i Policisë së Shtetit / Ministrisë së Punëve të Brendshme	Departamenti i Kufirit dhe Migracionit / Njësitë teknike të Ministrisë së Punëve të Brendshme	Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit
Portokalli (Përshkallëzim, Përgjigje Operacionale e Koordinuar)	Sektori i Analizës së Riskut dhe Statistikave (DKM) / monitoron dhe raporton çdo ditë tek drejtori i DKM-së	Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit	Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Policia e Shtetit / Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale / Ministria e Mbrojtjes Ministrinë e	Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit	Ministria e Punëve të Brendshme	Task-Forca Ndërinstitucionale Task-Forcat Operacionale Vendore Qendra Kombëtare e Menaxhimit të Krizave Migratore	Task-Forca Operacionale Vendore → Task-Forca Ndërinstitucionale → QKMKM

			tjera përkatëse				
I Kuq (Krizë e Plotë, Sistemi nën Presion të Rëndë)	Departame nti për Kufirin dhe migracionin	QKMKM	Të gjitha strukturat operacionale në terren koordinohen nga Task- Forca Operacionale Vendore	QKMKM	Task- Forca Ndërinstitu cionale	Të gjitha institucionet përgjegjëse sipas Planit të Kontigjencë s+ masat shesë të ndërmarr nga Task- Forca	Task- Forca Operacion ale Vendore & Qendra Kombëtare për Menaxhimi n e Krizave Migratore (QKMKM) → Sekretariat i i Task- Forcës Ndërinstitu cionale


SEKSIONI 9. Plani i përgjigjes

Plani operacional përbëhet nga katër momente të integruara të proceseve të punës (workflow), si më poshtë:

1. Procesi në Pikat e Hyrjes;
2. Procesi i Përpunimit të Mëtejshëm,
3. Procesi brenda Vendit, si dhe
4. Procesi në Pikat e Daljes.

Të gjitha proceset e sipërpërmendura do të shoqërohen në vijim nga një përshkrim i përgjithshëm i aktiviteteve kryesore të përgatitjes dhe përgjigjes, duke ofruar në këtë mënyrë kuadrin e përgjithshëm për planin e emergjencës.

Procesi i përgjithshëm i punës/ Work-Flow 1: Pikat e Kalimit Kufitar



Nevojat: Shërbimet në zonat e pritjes duhet të përfshijnë: shërbime mjekësore, ushqim dhe ujë të pijshëm, shërbime sociale (mbështetje psikologjike, identifikim të fëmijëve të pashoqëruar). Gjithashtu duhet të disponohen informacione mbi procesin e regjistrimit dhe përzgjedhjes.

3. Zonat e Pritjes

Nevojat: Kapacitet për të regjistruar 700 persona në ditë, në secilën nga pikat e kalimit kufitar, në përputhje me sistemin ekzistues të menaxhimit të kufirit.

4. Regjistrimi i të dhënave

Nevojë: Formulari ekzistues duhet të rishikohet për të mundësuar një proces përzgjedhjeje më të shkurtër. Pikat e kontaktit do të jenë Policia Kufitare, Njësia e Antiterrorit dhe Drejtoria për Shtetësi dhe Refugjatë.

5. Përzgjedhja

Pas identifikimit të profilit, çdo rast i referohet Institucionit përkatës për përpunim të mëtejshëm.

Nevojat: Të gjitha të dhënat e mbledhura gjatë këtij procesi duhet të konsolidohen në një dosje të vetme dhe t'i përcillen institucionit që do të merret me ndjekjen/përpunimin e mëtejshëm.

6.1 Azil kërkues/
Person në nevojë
për mbrojtje
ndërkombëtare

6.2
Migrant i
parregullt

6.3 Person
në nevojë
për mbrojtje
sociale

6.4
Kërcëni
m
Potencial
sigurie

7. Përpunimi i mëtejshëm
sipas rastit (Shih procesin
e përpunimit të
mëtejshëm).

Procesi i përgjithshëm i punës/Work-Flow 2: Përpunimi i mëtejshëm – Qendra e tranzitit / Qendra “One Stop”

Në këtë seksion do të përshkruhen proceset e zakonshme që lidhen me tre aspekte të tjera të punës, duke paraqitur zgjidhjet afatgjata që duhet të vihen në dispozicion të të gjithë migrantëve dhe azil kërkuesve.

1. Mjedisi i Kontrollit të Sigurisë

Hyrja dhe Ndihma e Parë e Menjëhershme.

Kontrolli Fillestar i Sigurisë Personale dhe i Bagazheve.

2. Mjedisi për shëndetin dhe ndihmën e parë

Sigurimi i mjediseve funksionale për shëndetin.

Kontroll mjekësor për të gjitha personat e grupeve të përziera të migrantëve.

3. Objektet për regjistrim dhe identifikim

Mjedise pune me pajisjet e nevojshme për regjistrim dhe identifikim.

Punonjësit e BPM-së që do të merren me këtë proces.

4. Mjedisi për kërkuesit e azilit

Ofrimi i akomodimit të përkohshëm dhe qasja në shërbimet bazë.

Përpunimi i mëtejshëm i kërkesës për azil zhvillohet në qendrën afatgjatë.

5. Mjedisi për migrantët e parregullt

Ofrimi i strehimit të përkohshëm dhe qasjes në shërbimet bazë.

Përpunimi i mëtejshëm për kthim.

6. Objektet e Mbrojtjes Sociale

Ofrimi i strehimit të përkohshëm dhe qasja në shërbimet bazë.

Sigurohet mbrojtje sociale.

7. Identifikimi i personave që mund të përbëjnë një kërcënim potencial për sigurinë

Pas identifikimit të një kërcënimi potencial, individi ndahet nga grupi dhe procedohet sipas rregullave.

Bashkëpunohet me Njësinë Anti-terror dhe Shërbimin Informativ Shtetëror (SIISU)

Procesi i përgjithshëm i punës/Work-Flow 3: Brenda Vendit

Zbatimi i këtij procesi pune është i rëndësishëm për të reduktuar risqet nga lëvizjet kriminale brenda vendit. Mungesa e një sistemi të transportit publik brenda vendit i lë migrantët dhe azil kërkuesit me vetëm dy mundësi: ecjen në këmbë ose përdorimin e transportit publik, duke i bërë ata më të cenueshëm ndaj trafikimit të qenieve njerëzore.

Nevojat: Shtimi i patrullimeve të policisë

dhe kontrolleve të rregullta të sigurisë në rrugët

kryesore, me qëllim rritjen e sigurisë

publike dhe parandalimin e rreziqeve të mundshme.

1. Patrullime dhe kontrolle sigurie në rrugët kryesore

Nevojat: Trajnime të mëtijshme për policinë, në mënyrë që të kryejë

procedurat e identifikimit duke respektuar plotësisht të drejtat e njeriut.

Policia duhet t'i referojë menjëherë rastet tek Drejtoria

Rajonale për Kufirin dhe Migracionin.

2. Identifikimi dhe referimi për asistencë i Shtetasve të Vendeve të Treta pa
status

Nevojat: Është e nevojshme që transporti drejt strukturave më

të afërta të jetë i disponueshëm menjëherë

3. Transport drejt qendrës më të afërt për azilkërkues për regjistrim dhe pre-
screening

Nevojat: Është e nevojshme të shtohen patrullimet e

policisë dhe kontrollet e sigurisë në rrugët kryesore

4. Shihni fluksin e punës për përpunimin e mëtijshëm dhe hapat vijues

Procesi i përgjithshëm i punës/ Work-Flow 4: Pikat e Daljes

1. Kufiri Blu dhe Jeshil

Nevojat: Trajnime të mëtejshëm për policinë, në mënyrë që të kryejnë

procedurat e identifikimit duke respektuar plotësisht të drejtat e njeriut.

Policia duhet t'i referojë menjëherë rastet tek Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin për përpunim të mëtejshëm.

2. Identifikimi dhe referimi për asistencë i Shtetasve të Vendeve të Treta pa status

Nevojat: Të forcohet mbikëqyrja kufitare në

kufijtë blu dhe jeshil, me fokus të veçantë në pikat e mundshme të kalimit për

udhëtimin pasues. Roja Bregdetare duhet të jetë e

përgatitur për operacione kërkim-shpëtimi.

3. (Vetëm për kufijtë tokësorë) Kapaciteti për të strehuar shtetas të vendeve të treta pa status, nëse është e nevojshme

Nevojat (vetëm për kufijtë e gjelbër): Strehimi

i tyre i përkohshëm në Shkodër duhet të jetë gati, në

rast se transporti i menjëhershëm në qendrën më të afërt nuk është i mundur.

Shërbimet mjekësore, ushqim dhe ujë i pijshëm, shërbime sociale (mbështetje psiko-sociale),

Identifikimi i të miturve të pashoqëruar ose të mitur të ndarë).

4. Transport drejt qendrave më të afërta për azilkërkues, migrantë të parregullt ose strukturave të mbrojtjes sociale, sipas nevojës.

Nevojat: Është e nevojshme që transporti (për grupe të mëdha migrantësh) nga pikat e kalimit drejt qendrave më të afërta të mos ndërpresë mbikëqyrjen kufitare.

5. Shihni procesin e përpunimit të mëtejshëm për hapat vijues.

SEKSIONI 10. Plani operacional

Plani i kontigjencës është i strukturuar sipas skenarëve të paracaktuar, të cilët pasqyrojnë nivele të ndryshme të intensitetit dhe kompleksitetit në menaxhimin e flukseve migratore. Për secilin skenar, janë përcaktuar qartë veprimet që duhet të ndërmerren, institucionet përgjegjëse për zbatim, si dhe burimet njerëzore, teknike dhe financiare të nevojshme, shoqëruar me afatet përkatëse të zbatimit. Kjo qasje e bazuar në skenarë siguron një reagim të përshkallëzuar, koordinim ndërinstitutional dhe përdorim efikas të kapaciteteve ekzistuese, duke mundësuar njëkohësisht aktivizimin në kohë të burimeve shtesë për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive çdo eskalimi nga një skenar në tjetrin.

Drejtoria përgjegjëse për Migracionin dhe Azilin në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si njësi teknike përgjegjëse, mbledh dhe përpunon të dhëna mbi zbatimin e planit çdo 6 muaj si dhe është përgjegjëse për të filluar procesin e rishikimit të Planit.

Procesi i vlerësimit dhe rishikimit të Planit Kombëtar të Kontigjencës për Flukset e Përziera Migratore, nis pas miratimit të një Urdhri të Kryeministrit. Ky proces drejtohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, e cila ka rolin koordinues ndërinstitutional për këtë fushë.

Rishikimi i planit është parashikuar të realizohet në katërmujorin e fundit të vitit 2028, përveç rasteve kur një ndryshim i madh në kontekstin kombëtar apo ndërkombëtar (si rritje e ndjeshme e flukseve migratore, ndryshime ligjore apo strukturore) kërkon një rivlerësim të menjëhershëm.

Procesi fillon me krijimin e një Grupi Ndër Institutional Teknik, të përbërë nga përfaqësues të institucioneve kryesore përgjegjëse.

Në vijim, GNIT realizon një analizë të boshllëqeve dhe një rivlerësim të rreziqeve, për të

siguruar që skenarët dhe masat të jenë ende të zbatueshme.

Në bazë të këtyre gjetjeve, hartohet një version i rishikuar i planit, i cili më pas konsultohet me të gjitha institucionet përkatëse dhe, pas miratimit ndërinstitucional, i paraqitet për miratim Këshillit të Ministrave.

Plani Operacional- Skenari Jeshil

Sektori	Veprimet	Institucioni Përgjegjës	Burimet (Njerëzore & Teknike)	Afati i Zbatimit
Menaxhimi i Kufirit (tokësor & detar)	Kontrolli kufitar kryhet mbi bazën e analizës së riskut sipas planifikimit standard operativ	DKM	Personel ekzistues i DKM, mjete të analizës së rrezikut	Vazhdimisht
	Sigurimi i trajnimeve të vazhdueshme për 613 punonjës policie të DKM mbi procedurat e regjistrimit dhe verifikimit kufitar	ASP	Qendra trajnimi, trajnerë, materiale	Brenda 6 muajve nga miratimi i PK
	Kryerja e identifikimit dhe verifikimit të përkthyesve të licencuar dhe krijimi i një regjistri mbështetës gjatë procedurave të regjistrimit dhe kontrollit kufitar	MPB,MD	Regjistër përkthyesish, mjete verifikimi	Brenda 6 muajve nga miratimi i PK
Mirëqenia Sociale	Trajnime të vazhdueshme për punonjësit socialë, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve dhe personelin mjekësor në nivel rajonal dhe lokal për trajtimin e migrantëve,	MSHMS Bashkitë, ASHMDF, SHSSH, OJF	Trajnerë, module trajnimi, ambiente trajnimi	Brenda 6 muajve nga miratimi i PK

	identifikimin, referimin dhe mbështetjen e personave vulnerabël			
Procedurat & Azili	Monitorimi i shqyrtimit të kërkesave për azil (aplikime, intervista, vendime) dhe vlerësimi i kapaciteteve vendimmarrëse duke përdorur procedurat e mbrojtjes së përkohshme, si pikë reference	MPB	Mjete monitorimi, personel	Brenda 3 muajve nga miratimi i PK
	Identifikimi i personelit (në MB dhe ministri të tjera) të trajnuar në procedurat e azilit	MPB	Bazë të dhënash për personelin	Brenda 3 muajve nga miratimi i PK
	Identifikimi dhe krijimi i një baze të dhënash të ekspertëve të pavarur për çështjet e azilit	MPB	Bazë të dhënash për ekspertët	Brenda 3 muajve nga miratimi i PK
	Organizimi i trajnimeve dhe praktikave profesionale për stafin e përfshirë në procedurat e azilit, (me personel të angazhuar me Urdhër Ministri)	MPB	Trajnerë, ambiente, materialet/ programet e trajnimit	Brenda 6 muajve nga miratimi i PK
	Identifikimi i përkthyesve të gjuhëve të rralla, krijimi i një baze të dhënash dhe ofrimi i trajnimeve të specializuara për përkthyesit e angazhuar nga OJQ-	MPB	Bazë të dhënash për përkthyesit, materialet/ programet e trajnimit	Brenda 6 muajve nga miratimi i PK

	të mbi procedurat e azilit			
	Përdorimi online i përkthyesve për intervistat e azilit (në koordinim me MARRI), krijimi i hapësirave të dedikuara për intervista, integrimi i rrjetit rajonal të përkthyesve	MPB	Platformë për përkthim online, hapësira të dedikuara për intervista	Brenda 6 muajve nga miratimi i PK
	Trajnimi i stafit të QPA për menaxhimin e rasteve, identifikimin e vulnerabilitetit, trajtimin e aplikimeve dhe regjistrimin	MPB, QPA	Trajnerë, udhëzues, ushtrime simulimi	Brenda 6 muajve nga miratimi i PK
	Planifikimi për burime njerëzore të specializuara shtesë në QPA	QPA	Mjete planifikimi për BNJ, burime rekrutimi	Brenda 6 muajve nga miratimi i PK
Informacioni	Shkëmbim periodik informacioni ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe MB	MPB	Platformë shkëmbimi informacioni	Çdo muaj
Siguria	Monitorimi dhe vlerësimi i sigurisë dhe rendit publik në pikat kryesore hyrëse	DKM	Ekipe të monitorimit të sigurisë	Vazhdimisht
Shëndetësia	Trajnimi i stafeve të institucioneve shëndetësore për njohjen e faktorëve socialë, gjuhësorë dhe kulturorë që ndikojnë në aksesin dhe përvojën e migrantëve me shërbimet shëndetësore	MSHMS	Trajnerë, ambiente, udhëzues trajnimi	Brenda 6 muajve nga miratimi i PK
	Ofrimi i shërbimeve	MSHMS	Ekspertë teknikë,	Brenda 6 muajve nga

	shëndetësore për migrantët nga strukturat spitalore vendore të kujdesit shëndetësor pranë pikave të kalimit kufitar, në zbatim të sistemit të referimit		grup pune	miratimi i PK
--	---	--	-----------	---------------

Plani Operacional-Skenari i verdhë

Sektori	Veprimet	Institucionet Përgjegjëse	Burimet (Njerëzore & Teknike)	Afati i Zbatimit
Menaxhimi i Kufirit (tokësor & detar)	Shtimi i pikave të punës në kufi për të mbështetur procesin e përzgjedhjes (identifikim, regjistrim, kategorizim, referim)	DKM	20 poste shtesë, ambiente zyre, pajisje IT	48 orë
	Rorientimi i personelit ekzistues në zonat prioritare	ASP, DKM	Personel ekzistues i DKM i rishpërndarë në zonat me nevojë të lartë	48 orë
	Trajnimeve të specializuara për verifikimin, personelit të menaxhimit kufitar	DKM, Instituti i Policisë Shkencore, Drejtoria e IT	25 punonjës të trajnuar/vit; ambiente trajnimi; pajisje IT	72 orë

	Aktivizimi i përkthyesve në pikat e nxehta	MPB, OJQ	13 përkthyes nga baza e të dhënave; pajisje interpretimi	48 orë
Transporti	Sigurimi i mjeteve shtesë tokësore dhe detare për transport	DKM	15 mjete tokësore, 5 mjete lundruese, karburant, drejtues mjetesh	72 orë
Ushqimi & Higjiena	Sigurimi i rezervave ushqimore dhe furnizimeve higjeno-sanitare në qendrat e përkohshme të pritjes	ASP, OJQ	Pako ushqimi & higjeno-sanitare për 7 ditë/person	24 orë
Mirëqenia Sociale	Vendosja e punonjësve social dhe psikologëve të strukturave vendore në gatishmëri për angazhim të menjëhershëm	MSHMS, Bashkitë, ASHMDF, SHSSH	12 punonjës social, 6 psikolog, paketa mbështetjeje të lëvizshme/mobile	72 orë
Akomodimi (qendrat kufitare)	Transferimi i migrantëve nga qendrat e përkohshme kufitare në struktura të tjera	DKM	Mjete transporti, drejtues transporti, staf logjistik	48 orë
	Identifikimi dhe përgatitja e infrastrukturës për qendrat emergjente të përkohshme (Gjirokastrë, Vlorë, Korçë)	Prefekturat, Bashkitë	3 objekte me shërbimet infrastrukturore, shtretër, kushte higjeno-sanitare	5 ditë
Procedurat & Azili	Riorganizimi i stafit të azilit për shpërndarje optimale të ngarkesës së punës	MPB	Zyrtar të azilit të rishpërndarë; objektiv pune 4–6 raste/ditë	48 orë
	Trajnimi i stafit të Migracionit & Antitrafikut mbi procedurat e azilit	MPB	4 punonjës të trajnuar; ambiente & materiale/programe trajnimi	1 javë
	Kërkesa për ekspertë të jashtëm nga RMSA (përkthim, regjistrim, infrastrukturë)	MPB	Ekspertë RMSA; pajisje portative regjistrimi	1 javë

Koordinimi Ndërinstitucional	Zgjerimi i stafit të QPA për mbulimin e shërbimeve në fushat e përkthimit, punës sociale, higjienës, mirëmbajtjes, psikologjisë dhe infermierisë	MPB	7 punonjës të përkohshëm (përkthyes, 2 punonjës social, higjeno-sanitare mirëmbajtje, psikolog, infermier)	1 javë
	Krijimi i Task-Forcës Ndërinstitucionale, Task-Forcës Operacionale Vendore dhe QKMKM	MPB – Drejtoria e Politikave të Migracionit	Ambiente për mbledhje, mjete koordinimi	24 orë
Informacioni	Njoftime publike mbi situatën migratore në vend	MPB	Zyrtar komunikimi; kanale mediatike	24 orë
Siguria	Forcimi i sigurisë në qendrat e pritjes dhe QMH	ASP	100 oficer; pajisje mbrojtëse; mjete transporti	48 orë
Shëndetësia	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për migrantët nga institucionet shëndetësore në nivel lokal dhe rajonal, pranë qendrave të akomodimit për migrantët e parregullt, në përputhje me sistemin e referimit	MSHMS, Shtete Partner	-	Brenda 72 orëve

Plani Operacional - Skenari Portokalli

Sektori	Veprimet	Institucionet Përgjegjëse	Burimet (Njerëzore & Teknike)	Afati i Zbatimit
Koordinimi	Aktivizimi i Task-Forcës Ndërinstitucionale dhe Task-Forcave Operacionale Vendore	Zyra e Kryeministrit	Njerëzore: Anëtarët e Task-Forcës; Teknike: Ambiente për komunikim dhe mbledhje	24 orë
	Aktivizimi i QKMKM	MPB	Njerëzore: Stafi i menaxhimit të krizave; Teknike: Infrastrukturë e qendrës së komandës	24 orë
	Koordinimi me organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare	MPB	Njerëzore: Oficerë lidhës; Teknike: Platforma komunikimi	24 orë
	Përsheptimi i procedurave të prokurimit	MPB, Zyra e Kryeministrit	Njerëzore: Stafi i prokurimit; Teknike: Sistemet e prokurimit, baza e të dhënave të furnitorëve	48 orë

Menaxhimi i Kufirit	Shtimi i objekteve dhe 40 pozicioneve vakante pune për regjistrim dhe përzgjedhje në pikat kufitare	MPB, ASP, OJQ	Njerëzore: 40 punonjës shtesë; Teknike: Ambiente zyre, pajisje IT, sisteme regjistrimi	48 orë
	Rishpërndarja/transf erimi i personelit nga drejtoritë lokale DKM në pikat kufitare me fluks të lartë	DKM, FRONTEX	Njerëzore: Personel i ri-orientuar/ transferuar; Teknike: Transport dhe pajisje operative	48 orë
Transporti	Vendosja e 30 mjeteve për transportin e migrantëve nga kufiri në qendrat e pritjes	ASP, MPB, Ministria e Mbrojtjes, FA	Njerëzore: Drejtues mjetesh, staf shoqërues; Teknike: 30 mjete, GPS, furnizim me karburant	72 orë
Akomodimi i Përkohshëm	Operimi i 3 qendrave emergjente për pritje (Korçë, Gjirokastrë, Vlorë)	Task Forcat, Organizatat Partner	Njerëzore: Stafi i qendrës, sigurimi, mirëmbajtja; Teknike: Shtretër, higjienë, furnizim me ushqim, gjeneratorë energjie	5 ditë
Procedura & Azili	Ri-shpërndarja e burimeve njerëzore për ndjekjen e procedurave të azilit	MPB	Njerëzore: Zyrtar/ specialist azili; Teknike: Sistemet e menaxhimit të rasteve	48 orë
	Krijimi i vendeve të përkohshme të punës pranë qendrave kufitare për regjistrimin e azil kërkuësve	MPB	Njerëzore: Stafi i regjistrimit; Teknike: Ambient zyre, akomodim, sisteme IT	72 orë
	Mobilizimi i ekspertëve të jashtëm & mbështetje nga UNHCR për procedurat e azilit	MPB, UNHCR	Njerëzore: Ekspert ligjor/azili; Teknike: Pajisje përkthimi, materiale/pr ograme trajnimi	1 javë
	Rritja e stafit të QPA me 14 persona dhe	MPB	Njerëzore: 14 staf (përkthyes, punonjës	1 javë

	riorganizimi i hapësirave për 250–350 azilkërkues		socialë, mjek); Teknike: Shtretër, higjienë, mobilje	
Mirëqenia Sociale	Vendosja e punonjësve social, psikologëve dhe PMF 24/7 në kufi dhe qendrat e pritjes në bashkëpunim dhe koordinim me organizatat ndërkombëtare, kryesisht për rastet e të miturve të pashoqëruar	MSHMS, Bashkitë, OJQ, ASHDMF, SHSSH	Njerëzore: Punonjës social, psikolog, staf për mbrojtjen e fëmijëve; Teknike: Ambiente zyre, transport	72 orë
	Identifikimi dhe referimi i fëmijëve të mitur të pashoqëruar /viktimize të trafikut	ASHDMF, DKM, OJQ	Njerëzore: Punonjës për mbrojtjen e fëmijëve; Teknike: Sistemi referimit, baza e të dhënave (data bazë) për menaxhimi raste	72 orë
	Riorganizimi i hapësirave/personeli t në Qendrën Kombëtare të Pritjes për Viktimat e Trafikimit	MSHMS	Njerëzore: Punonjës social, psikolog, staf sigurie; Teknike: Objektet e strehimit, sistemet e sigurisë	72 orë
Ushqimi & Higjiena	Rritja e rezervave ushqimore/higjieno-sanitare për 375 migrantë në javë	Prefektura, Bashkitë, OJQ	Njerëzore: Staf logjistik/distribuid; Teknike: Ambient magazinimi, paketa higjienë	24 orë
Informacioni	Informimi i institucioneve përgjegjëse mbi situatën	TFNI	Njerëzore: Zyrtar komunikimi; Teknike: Platforma komunikimi	24 orë
	Informimi periodik i publikut	TFNI	Njerëzore: Zyrtar shtypi; Teknike: Kanale mediatike, ambiente	24 orë

			për konferenca	
Siguria	Rritja e pranisë policore në qendrat e pritjes	ASP	Njerëzore: Oficerë policie; Teknike: Mjete, pajisje komunikimi	48 orë
	Organizimi i mjeteve policore për siguri gjatë transportit	ASP	Njerëzore: Ekipë shoqëruese; Teknike: Mjete patrulluese	48 orë
	Angazhimi i forcave të armatosura për siguri shtesë	FA	Njerëzore: Personel ushtarak; Teknike: Pajisje sigurie	48 orë
Shëndetësia	Vendosja e 9 Ekipëve statike/të lëvizshme mjekësore dhe logjistika përkatëse për mbulimin me shërbim shëndetësor 24/7, në Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë	MSHMS, Shtete Partner	Njerëzore: 18 staf mjekësor; Teknike: paketa mjekësore, ambulanca	72 orë
	Angazhimi i epidemiologëve të strukturave vendore të kujdesit shëndetësor pranë pikave kufitare /qendrave pritëse.	MSHMS, Shtete Partner	Njerëzore: 3 epidemiologë; Teknike: paketa të testimi	72 orë

Plani Operacional- Skenari i Kuq

Sektori	Veprimet	Institucionet Përgjegjëse	Burimet (Njerëzore & Teknike)	Afati i Zbatimit
Koordinimi i Ndihmës Ndërkombëtare	Task-Forca kërkon dhe koordinon mbështetje teknike, financiare dhe humanitare për të përballuar krizën e migracionit	Qeveria, TFNI	Ekipe koordinimi, kanale komunikimi, zyrtar lidhës	24 orë
Menaxhimi i Kufirit	Rritje e kontrollit të kufirit me mbështetje të Forcave të Armatosura	PSH, FA, FRONTEX, TFNI	120 pozicione pune në qendra emergjente (40 Vlorë, 40 Korçë, 40 Gjirokastrë), mjete IT, logjistikë; 10 persona nga FA	24 orë
	Propozimi i masave ligjore alternative bazuar në vlerësimin e situatës për mbikëqyrjen dhe	TFNI, TFOV, OJQ, Partnerë Ndërkombëtarë	-	24 orë

	menaxhimin e kufirit (akt normativ/ligjor)			
Transporti	Transport emergjent për shpërndarjen e migrantëve nga kufiri në qendrat e pritjes (QPA, QKPVT, QFH)	ASP, FA, Mbështetje EU, Shtete Partner, IOM, UNHCR	20 furgona ASP, 20 kamionë FA, 10 kamionë të vegjël, 5 furgona, 5 autobusë, 1 helikopter emergjent	24 orë
Ushqimi & Higjiena	Sigurimi dhe shpërndarja e ushqimeve, veshmbathjeve, produkteve të higjienës dhe shërbimeve sanitare	TFOV, Organizata Partnere	Furnizime për 700 migrantë/në javë (ushqim, paketa higjeno-sanitare, veshmbathje)	24 orë
Mirëqenia Sociale	Personel shtesë i specializuar për grupet e cënueshme	MSHMS, SHSSH, ASHMDF, Bashkitë, Organizata Partner	18 punonjës social, 12 psikolog	Menjëherë
Akomodimi	Hapja e qendrave emergjente për pritjen e 700 migrantëve/në javë	TFNI, TFOV, Organizata Ndërkombëtare, OJQ	3 qendra emergjente me shërbime bazë, shtretër, higjeno-sanitare	Menjëherë
Informacioni	Task-Forca Ndërinstitucional nëpërmjet QKMK funksionon 24/7 për komunikim me aktorët institucional dhe publikun	TFNI	Infrastrukturë komunikimi, staf i dedikuar	24 orë
Siguria	Siguria në qendrat e pritjes (ekzistuese dhe emergjente)	ASP, FA	Personel i FA 60, 45 oficerë të PSH, pajisje mbrojtëse, transport	24 orë
Shëndetësia	Ofrimi i shërbimeve mjekësore dhe të shëndetit publik për 700 migrantë/në javë	MSHMS, QKU, Shërbimi Parësor Shëndetësor, OSHKSH, ISHP, QKUM, FSDKSH, OBSH, WHO, EU, Shtete Partner	12 ekipe mjekësore (2 mjekë + 2 infermierë secili = 36 staf), 6 epidemiologë, 3 ambulanca, 3 dhoma klinike, medikamente, pajisje mjekësore	24 orë
Azili	Mbështetje e sistemit të azilit me përkthyes, përfaqësues ligjor, psikolog, mediator kulturor dhe logjistik IT	MPB, QPA, UNHCR, RMSA	Burime njerëzore dhe pajisje kompjuterike	24 orë

	Procedura të përshpejtuara të azilit	MPB, QPA, UNHCR, RMSA	Staf i dedikuar, mjete për lehtësimin/thjeshtimin e punës	24 orë
	Procedurat e Mbrojtjes së Përkohshme Masive	MPB, QPA, UNHCR, RMSA	Kuadër ligjor, ekipe operationale	24 orë

SEKSIONI 11. Reagimi Ndërinstitucional dhe Masat e Menaxhimit për Flukset Migratore

Përballja me flukset emergjente migratore kërkon një qasje të koordinuar dhe të strukturuar ndërinstitucionale, të mbështetur në një plan të qartë kontigjence. Plani synon të garantojë një reagim të shpejtë, efektiv dhe human, duke respektuar të gjitha standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe duke ruajtur sigurinë kombëtare.

Në këtë kontekst, plani mbështetet në tre shtylla kryesore të organizimit dhe reagimit: **koordinimi ndërinstitucional, menaxhimi i pikave të hyrjes/daljes, si dhe strehimi emergjent.**

Lista e Kontakteve Ndërinstitucionale (Aneksi I)

Reagimi i koordinuar është jetik për menaxhimin efikas të çdo situatë që lidhet me flukset migratore. Për këtë arsye, është hartuar një **listë e detajuar e kontakteve ndërinstitucionale** që përfshin përfaqësues të strukturave të ndryshme shtetërore dhe partnere. Kjo strukturë e komunikimit mundëson veprim të përbashkët dhe shmangje të vonesave në reagim.

Pikat e Hyrjes dhe Daljes (Aneksi II)

Një komponent tjetër thelbësor është identifikimi dhe menaxhimi i **pikave të hyrjes dhe daljes në kufijtë shtetërorë** të Republikës së Shqipërisë. Në Aneksin II janë përfshirë të gjitha pikat zyrtare kufitare, përfshirë pikat e reja që do të hapen.

Plani për Qendrat e Akomodimit Emergjent (Aneksi III)

Në rast të flukseve të mëdha migratore, është parashikuar ngritja e **qendrave të akomodimit emergjent** në qarqet kufitare, sipas një plani të detajuar që ndodhet në Aneksin III. Këto qendra do të jenë të pajisura me:

- Kapacitete për strehim të përkohshëm;
- Shërbime bazë: ushqim, ujë të pijshëm, ndihmë mjekësore, higjienë;
- Strukturë për regjistrimin dhe identifikimin e të ardhurve;
- Prani të oficerëve të mbrojtjes së fëmijëve dhe ndihmës psikologjike për rastet vulnerabël.

Qendrat janë planifikuar në bashkëpunim me autoritetet vendore dhe do të aktivizohen menjëherë pas shpalljes së një situatë emergjente.

SEKSIONI 12: Buxhetimi

Ky Seksion paraqet shpërndarjen e kostove indikative dhe burimet financiare për financimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit (**Aneksi IV**) në zbatim të Planit të Kontigjencës për flukset e përziera migratore, **për vitet 2026–2028**. Procesi i kostimit është realizuar duke marrë në konsideratë skenarët apo modelin e përshkallëzimit të flukseve migratore. Numri i skenarëve është katër dhe secili nga skenarët qëndron më

vete. Vlerësimi i kostove është kryer në përputhje me **metodologjitë e planifikimit buxhetor (Aneksi V)**, pra mbështetet në qëllimet, objektivat, treguesit e performancës dhe burimet e të identifikuar nga ekspertët për secilin aktivitet dhe/ose sektor.

Përlllogaritjet e kostove indikative janë kryer duke **detajuar zërat e shpenzimeve për secilin aktivitetet**, të përshtatur sipas informacioneve të marra nga ekspertët e sektorit, dhe janë harmonizuar me **Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028**, për aq sa ka qenë e mundur. Ky proces është zhvilluar në konsultim me anëtarët e grupit të punës, disa nga drejtoritë përkatëse të buxhetit në ministritë e linjës, institucionet e përfshira në zbatimin e planit të kontigjencës, sugjerimet e ekspertëve ndërkombëtar, etj.

Planit Kombëtar i Kontigjencës shoqërohet me një kostim **analitik**, i cili përfshin një klasifikim të shpenzimeve në kategori të qarta si:

- Paga dhe sigurime shoqërore;
- Shpenzime të tjera korrente;
- Investime.

Përlllogaritjet janë realizuar sipas viteve financiare, duke paraqitur një shpërndarje të qartë të kostove indikative dhe fondeve që nevojiten për secilin aktivitet. Kostot indikative dhe burimet e financimit duhen lexuar sipas skenarëve.

Skenari i Jeshil ose gjendja normale është situatë plotësisht e qëndrueshme dhe nën kontroll. Kostoja indikative totale për zbatimin e planit të kontigjencës për periudhën 2026–2028 sipas këtij skenari është vlerësuar rreth 195.6 milionë lekë. Fondet që nevojiten për zbatimin e aktiviteteve të planit janë brenda tavaneve buxhetore. Hendek financiar është identifikuar vetëm për vitin 2026 dhe është rreth 3.47 milionë lekë ose 1.8% e kostove indikative të llogaritura për skenarin jeshil për të gjithë periudhën 2026–2028. Ndërsa 10.3% kostove indikative totale janë planifikuar të mbulohen nga organizata partnere dhe/ose organizata ndërkombëtare për periudhën 2026–2028 dhe janë të lidhura kryesisht me ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin.

Skenari i Verdhë ose Paralajmërimi shënon një rritje të lehtë dhe të vazhdueshme të fluksit migrator, duke vendosur sistemin në një nivel më të lartë vigjilence. Kostoja indikative totale për zbatimin e planit të kontigjencës për periudhën 2026–2028 sipas këtij skenari është vlerësuar rreth 529.4 milionë lekë. Nëse ndodh ky skenar lind nevoja për mbulimin e disa kostove që janë identifikuar si hendek financiar dhe lidhen me transportin e migrantëve, rezervat ushqimore dhe paketat hidrosanitare, si dhe transferimin e migrantëve nga qendrat e përkohshme në objektet e tjera. Kostoja indikative totale e mbuluar nga buxheti është rreth 254 milionë lekë për të gjithë periudhën dhe është e shpërndarë pothuajse në të njëjtin nivel për secilin vit buxhetor. Hendeku financiar është 48.3% ose rreth 255.8 milionë lekë për të gjithë periudhën 2026-2028 dhe është pothuajse në të njëjtin nivel për çdo vit buxhetor. Ky fond nevojitet vetëm nëse kalohet në këtë skenar.

Skenari Portokalli ose Emergjencia karakterizohet nga rritja të konsiderueshme e fluksit, ku sistemet ekzistuese fillojnë të ndiejnë presion serioz. Kostoja indikative totale për zbatimin e planit të kontigjencës për periudhën 2026–2028 sipas këtij skenari është vlerësuar rreth 499.5 milionë lekë. Në këtë skenar lind nevoja për mbulimin e disa kostove që janë identifikuar si hendek financiar dhe lidhen me shtimin e facilitetëve dhe posteve të punës, transportin e migrantëve, operimin i 3 qendrave të tjera emergjente, etj. Hendeku financiar është rreth 71.% ose rreth 357.5 milionë lekë për të gjithë periudhën 2026-2028. Ky fond nevojitet vetëm nëse kalohet në këtë skenar. 18.8% kostove indikative për këtë skenar janë planifikuar të mbulohen nga organizata partnere dhe/ose organizata ndërkombëtare.

Tabela1: Kostot financiare, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë periudhës 2026-2028 (në lekë)								
Skenari	Shpenzim e paga + sig shoqerore	Shpenzime të tjera operative	Investime	TOTALI KOSTO INDIKATIVE	Financuar nga buxheti	Financuar nga Donatore/Organi zata Partnere	Hendeku financiar	% e hendekut financiar
1. Normalitet	140,044,061	52,772,059	2,875,000	195,691,120	172,147,582	20,068,539	(3,474,999)	1.8%
Viti 2026	50,183,427	21,037,384	2,875,000	74,095,811	61,678,673	8,942,139	(3,474,999)	4.7%
Viti 2027	44,930,317	15,883,501	-	60,813,818	55,250,618	5,563,200	-	0.0%
Viti 2028	44,930,317	15,851,174	-	60,781,491	55,218,291	5,563,200	-	0.0%
2. Paralajmërim	121,364,878	382,815,353	25,300,000	529,480,231	254,031,678	19,613,430	(255,835,123)	48.3%
Viti 2026	40,454,959	127,605,118	13,800,000	181,860,077	86,977,226	6,537,810	(88,345,041)	48.6%
Viti 2027	40,454,959	127,605,118	5,750,000	173,810,077	83,527,226	6,537,810	(83,745,041)	48.2%
Viti 2028	40,454,959	127,605,118	5,750,000	173,810,077	83,527,226	6,537,810	(83,745,041)	48.2%
3. Emergjencë	226,426,737	241,071,708	32,085,000	499,583,446	47,801,554	94,253,510	(357,528,382)	71.6%
Viti 2026	75,475,579	82,291,383	32,085,000	189,851,962	14,934,933	34,016,755	(140,900,274)	74.2%
Viti 2027	75,475,579	79,390,163	0	154,865,742	20,331,688	26,220,000	(108,314,054)	69.9%
Viti 2028	75,475,579	79,390,163	0	154,865,742	12,534,933	34,016,755	(108,314,054)	69.9%
4. Krizë	292,445,217	385,860,059	30,475,000	708,780,276	91,343,804	159,882,795	(457,553,677)	64.6%
Viti 2026	97,481,739	128,620,020	30,475,000	256,576,759	36,927,935	53,294,265	(166,354,559)	64.8%
Viti 2027	97,481,739	128,620,020	0	226,101,759	27,207,935	53,294,265	(145,599,559)	64.4%
Viti 2028	97,481,739	128,620,020	0	226,101,759	27,207,935	53,294,265	(145,599,559)	64.4%

Skenari i Kuq ose Kriza është skenari më kritik, përfaqëson krizë të plotë, flukset migratore janë shumë të larta dhe tejkalojnë kapacitetet shtetërore. Kostoja indikative totale për zbatimin e planit të kontigjencës për periudhën 2026–2028 sipas këtij skenari është vlerësuar rreth 708.7 milionë lekë. Në këtë skenar lind nevoja gjithashtu si në rastin e emergjencës për mbulimin e kostove që janë identifikuar si hendek financiar dhe lidhen me rritjen e kontrollit kufitar, shtimin e facilitetëve dhe posteve të punës, transportin e migrantëve, operimin e qendrave emergjente, etj. Kostoja indikative është rreth 230 milionë lekë në vit. Hendeku financiar është rreth 64.6% ose rreth 457.5 milionë lekë për periudhën 2026–2028, dhe ky fond nevojitet vetëm nëse do të ndodh ky skenar. 22.6% kostove indikative për këtë skenar janë planifikuar të mbulohen nga organizata partnere dhe/ose organizata ndërkombëtare.

Në përlllogaritjen e kostove janë identifikuar dhe kufizime që kërkojnë rishikim të mëtejshëm dhe të vazhdueshëm, në varësi të skenarëve. Në mënyrë të veçantë duhet të planifikohen alokimet që janë të mbuluara nga burimet ekzistuese. Bazuar në analizën e mësipërme, rishikimi i kostove dhe burimeve të financimit mbetet një proces dinamik që do të varet nga flukset migratore.

Aneksi I

LISTA E KONTAKTEVE

Nr.	Institucioni	Email	Tel
1.	Ministria e Mbrojtjes: Drejtor i Drejtorisë së Integritimit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve	edlira.abazi@mod.gov.al	0675077711
2	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë: Drejtor i Drejtorisë së Sigurisë Detare dhe Administrimit dhe Kontrollit të Flamurit në Drejtorinë e Përgjithshme Detare	muharrem.trupja@dpdetare.gov.al	0699425435
3.	Ministria e Financave: Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor	Gentian.opre@financa.gov.al	0682052619
4.	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Shëndetësisë;	mejvis.kola@shendetesia.gov.al	0672088966
5.	Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Mbrojtjes Sociale	jona.dervishaliaj@shendetesia.gov.al	0697604044

6.	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit: Drejtori Departamentit për Kufirin dhe Migracionin	saimir.boshnjaku@asp.gov.al	0694102301
7.	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile: Përgjegjës i Sektorit të Paralajmërimit, Mbështetjes Operacionale dhe Humanitare	leonard.qyra@akmc.gov.al	0682004346
8.	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile: Përgjegjëse e Sektorit të Projekteve IPA dhe Programeve të tjera Ndërkombëtare	fatjona.xhaferi@akmc.gov.al	0694133473
9.	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile: Specialist në Sektorin e Planifikimit të Mbrojtjes Civile	sadik.balliu@akmc.gov.al	0694115707
10.	Forcat e Armatosura: Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura	aleksander.pando@aaf.mil.al	0684029877
11.	Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin: Drejtor, Drejtorja e Politikave të Shtetësisë	Estela.Palnikaj@mb.gov.al	0682429241

12.	Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin: Drejtor, Drejtoria e Politikave të Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut	Alma.Bime@mb.gov.al	0694132999
-----	--	--	-------------------

Aneksi II

PIKAT E HYRJES DHE DALJES NË KUFIJTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Lloji i Pikës Kufitare	Pika e Kalimit Kufitar (PKK)	Shënime / Shteti
Aeroporte (PKK ajrore)	Aeroporti i Rinasit	–
	Aeroporti i Kukësit	–
Portet detare (PKK detare)	Porti i Durrësit	–
	Porti i Vlorës	–
	Porti i Sarandës	–
	Porti i Shëngjinit	–
	Porti i Himarës	–
	Porto Romano (transport karburanti)	–
	Petrolifera	–
	Limion	–
	Marina Orikum	–
Liqenet / Ujërat e Brendshëm (PKK liqenore)	Moli i Qytetit, Pogradec	Sezonal, me Maqedoninë e Veriut
Hekurudha (PKK hekurudhore)	Tuz	Pikë e përbashkët me Policinë e Malit të Zi
Kufijtë tokësorë (PKK tokësore)	Me Kosovën:	–
	Morinë	–

	Qafë Morinë	–
	Qafë Prush	–
	Shishtavec	–
	Orgjost	–
	Borje	–
	Çerem	–
	Me Malin e Zi:	–
	Muriqan	–
	Grabom	–
	Hekurudha Tuz	–
	Hani i Hotit	–
	Bashkim	–
	Me Maqedoninë e Veriut:	–
	Qafë Thanë	–
	Tushemisht	–
	Gorricë	–
	Bllatë	–
	Xhepsht / Trebisht	–
	Me Greqinë:	–
	Kakavijë	–
	Tre Urat	–
	Sopik	–
	Kapshticë	–
	Qafë Botë	–
	Rips	–
PKK të reja / të planifikuara	Aeroporti i Vlorës	–
	Pikë e Përbashkët Kufitare Zogaj RSH-Çklla/Skje	Mali i Zi
	Pikë e Përbashkët Kufitare Shën Nikol	

Aneksi III

PLANI PËR KRIJIMIN E QENDRAVE TË AKOMODIMIT EMERGJENT NË QARQET KORÇË, VLORË DHE GJIROKASTËR

Qarku Korçë

1. Bashkia Korçë:

Njësia Administrative Mollaj, fshati Floq (ish-TAP).



2. Bashkia Pogradec:

Zona kadastrale 2420. Pasuritë nr.77/1 me sip. 5.900 m² dhe nr.77/2 me sip. 5.500 m²



3. Bashkia Devoll:

Pasuritë qytet Bilisht ZK.1187 me nr: 6/74 me sip. 410 m², nr. 6/75 me sip. 370 m², nr. 6/76 me sip. 390 m², nr. 6/79 me sip. 613 m², nr. 6/83 me sip. 450 m², nr. 6/84 me sip. 450 m².



Pasuria Bitinckë ZK.1202 me nr. 783/2 me sip. 8858 m².

Total sipërfaqe 11.511 m². të cilat janë në pronësi të Bashkisë Devoll.



4. Bashkia Kolonjë:

Vendi ish-fusha e futbollit Leskovik, mund të shfrytëzohen rreth 5000 m².



5. Bashkia Maliq:

Ish-depot e Rezervave Lozhan.



6. Bashkia Pustec:

Njësia Zaroshkë (Rallnik) Plepat, sip. 10.000 m²



Fusha Sportive Pustec, sip. 3.800 m²



Fusha Sportive Goricë e Vogël, sip. 5.300 m²



Qarku Gjirokastrë

Në Qarkun e Gjirokastrës, po shqyrtohet krijimi i qendrave të përkohshme të pritjes emergjente në disa njësitë administrative, me qëllim sigurimin e akomodimit të shpejtë të migrantëve në rast nevojë. Strukturat e ish-Rezervave Shtetërore, të vendosura në të gjithë qarkun dhe historikisht të përdorura me efikasitet gjatë krizës së vitit 1999 për pritjen e bashkëkombësve nga Kosova, mund të rikonfigurohen për akomodim të përkohshëm, në varësi të vlerësimeve teknike të gjendjes së tyre aktuale.

Në Bashkinë Memaliaj, është identifikuar një vend i përshtatshëm pranë Stadiumit "Karafil Çausi", për vendosjen e strukturave të përkohshme të akomodimit. Në Bashkinë Përmet, si Spitali i Përmetit ashtu edhe konviktet e qytetit mund të përdoren si objekte të përkohshme të akomodimit, duke ofruar një kapacitet prej 102 shtretërish. Këto masa synojnë të shfrytëzojnë infrastrukturën ekzistuese në mënyrë efikase, duke siguruar gatishmëri për situata emergjente.

Qarku Vlorë

1. Bashkia Vlorë:

Aktualisht, Bashkia Vlorë disponon një sërë hapësirash të përshtatshme për akomodim emergjent, përkatësisht:

- Konvikti i "Qytezës Studenti"
- Konvikti i Shkollës "Industriale"

Gjithashtu, për situata të krizës, mund të përshtaten:

- Pallati i Sportit "Flamurtari"
- Shkolla e Marinës

- Zyrrat e Njësissë Administrative Novoselë

Kapaciteti akomodues i secilës prej hapësirave të mësipërme arrin deri në 300 persona.

2. Bashkia Selenicë

Vendndodhja: Fshati Peshkopi

Tipi i hapësirës: Truall i lirë

Koordinata: 40°28'17"N, 19°35'12"E

Sipërfaqe: 4.409 m²

Kapaciteti: 250 persona

3. Bashkia Delvinë

- Stadiumi i futbollit të qytetit Delvinë

4. Bashkia Himarë

Hapësira e evidentuar aktualisht: Stadiumi në qendër të Himarës.

Ambiente të shkollave publike në zonën e bashkisë.

Njëkohësisht në proces vlerësimi për shtim të hapësirave alternative.

5. Bashkia Konispol

- Shkolla e Konispolit – kapacitet rreth 150 persona
- Shkolla e Xarrës – kapacitet rreth 100 persona
- Shkolla e Mursisë – kapacitet rreth 100 persona
- Qendra Komunitare Mursi – kapacitet rreth 60 persona